

# Implentueshmëria e ligjeve në fushën e punës





Publikuar nga:

Qendra për Politika dhe Avokim

[www.qpa-rks.org](http://www.qpa-rks.org)

[info@qpa-rks.org](mailto:info@qpa-rks.org)

+383 (0) 38 226 530

Të drejtat e autorit © 2021. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky hulumtim publikohet brenda kornizës së projektit "Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë" i cili implementohet nga UNOPS dhe financohet nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij punimi pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve që janë përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të UNOPS, Ambasadës së Suedisë, ose Agjencisë Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim.





# NIVELI I IMPLEMENTIMIT DHE IMPLEMENTUESHMËRISË I KORNIZËS LEGJISLATIVE NË FUSHËN E PUNËS

## Përmbajtja

Hyrje .....	4
Gjendja aktuale e Kornizës Legjislative .....	5
LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS.....	6
LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË.....	7
Fushëveprimi i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në vendin e punës dhe kolizioni me ligjet e tjera.....	8
Mos harmonizimi i gjobave në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës me Ligjin për Kundërvajtje.....	8
E drejta e ankesës në lidhje me gjobën.....	9
LIGJI Nr. 05/L -062 PËR SIGURI NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE .....	10
LIGJI NR. 2002/9 PËR INSPEKTORATIN E PUNËS.....	11
Fushëveprimi i Ligjit për Inspektoratin e Punës.....	12
Institucionet Përgjegjëse në Fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë .....	13
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve .....	13
Inspektorati i Punës .....	14
Gjendja aktuale e IP-së.....	15
Sfidat e Inspektoratit të Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kornizës Legjislative të Punësimit.....	16
Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë .....	19
Inspektorati i Minierave .....	19
Organizmi i Inspektoriatit të Minierave .....	20
Gjendja aktuale e sigurisë dhe shëndetit në punë në veprimtarinë minerare .....	21
Mungesa e bashkëpunimit mes Inspektorateve .....	23
Harmonizimi i legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë me legjislacionin e BE-së.....	23
Rishikim i Planit Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021) .....	25
Objektiva Strategjike 1:.....	26
Objektiva Strategjike 2:.....	26





Objektiva Strategjike 3:.....	27
Objektiva Strategjike 4:.....	28
Analizë krahasimore .....	29
Shqipëria .....	29
Gjendja aktuale e sigurisë dhe shëndetit në punë.....	29
Korniza Legjislative .....	30
Korniza Institucionale.....	30
Kroacia .....	33
Gjendja aktuale .....	33
Korniza Legjislative .....	33
Korniza Institucionale.....	34
Sllovenia.....	37
Gjendja aktuale .....	37
Korniza legjislative .....	37
Korniza Institucionale.....	38
MAQEDONIA E VERIUT.....	40
Gjendja aktuale e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.....	40
Korniza Legjislative .....	41
Korniza Institucionale.....	41
Serbia .....	43
Gjendja aktuale në Serbi.....	43
Korniza Legjislative .....	43
LETONIA .....	45
Korniza Legjislative .....	45
Korniza institucionale.....	46
Rekomandime .....	51





## Hyrje

Siguria dhe Shëndeti në Punë në Republikën e Kosovës cilësohet si një ndër fushat më pak të zhvilluara për arsye se ndër vite vazhdon të ballafaqohet me kriza të shumta.

Me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës, siguria dhe shëndeti në vendin e punës përcaktohet si "pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës".<sup>1</sup>

Organet përgjegjëse prej kohësh kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në kornizën legjislative që ka të bëjë me fushën e Sigurisë dhe Shëndetin në Vendin e Punës. Korniza Legjislative kosovare ka adaptuar një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore sipas standardeve të Bashkimit Evropian (referuar me BE në vazhdim), ku si bazë themelore kanë garantimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Mirëpo, adaptimi i tyre nuk rezultoj pozitiv në praktikë, pasi të dhënat nga Inspektorati i Punës tregojnë një numër të lartë të aksidenteve në vendin e punës. Viti 2021 në dekadën e fundit shënon vitin me numrin më të lartë të aksidenteve në punë, me gjithsej 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) aksidente<sup>2</sup>, pavarësisht faktit se veprimtaritë me rrezik më të lartë nuk kanë operuar me muaj të plotë për shkak të pandemisë.

Ky numër i lartë i aksidenteve në vendin e punës ndër vite në Kosovë tregon shkallën e ulët të sigurisë dhe shëndetit në punë. Zbatimi i pjesshëm i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe mos krijimi i kushteve të mirëfillta për të punësuarit, ndikon në numrin e lartë të aksidenteve.<sup>3</sup> Arsye tjetër konsiderohet edhe mos efikasiteti i autoriteteve përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve, në këtë rast i Inspektoratit të Punës, për shkak të kapaciteteve të kufizuara profesionale dhe teknike. Kështu, vetëm gjatë vitit 2021 kanë ngelur jashtë inspektimit rreth 96% e punonjësve.<sup>4</sup> Në anën tjetër, edhe pse numri i aksidenteve në vendin e punës është i lartë, shqiptimi i masave administrative nga organet kompetente është i ulët. Numri total i gjobave të shqiptuara nga Inspektorati i Punës në vitin 2021 ishte 281.<sup>5</sup>

Me anë të këtij dokumenti synohet të rishikohet korniza legjislative që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe puna e mekanizmave përgjegjës për këtë fushë, duke përfshirë edhe analiza me të dhëna statistikore nga burime relevante.

Përmes rishikimit ndër vite të kornizës legjislative që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, do të bëhet përshkrimi më i detajuar i saj. Veçanërisht do të analizohet pjesa e

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.

<sup>2</sup> Inspektorati i Punës (2022) Raporti i Punës.

<sup>3</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2017) Strategjia Sektoriale 2018-2022. Marrë nga: <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-2018-2022/>

<sup>4</sup> Inspektorati i Punës (2022) Raporti i Punës.

<sup>5</sup> Inspektorati i Punës (2022) Raporti i Punës.





implementimit të saj dhe kapaciteti i kornizës institucionale për mbikëqyrjen e implementimit të kornizës legjislativë. Kjo do të bëjë të mundur nxjerrjen në pah të numrit të lartë të pengesave dhe do të lehtësonte procesin e zbatimit të legjislacionit në praktikë si dhe përmes kësaj do të mundësohet promovimi i avancimit të kornizës legjislativë dhe institucionale për punonjësit dhe punëdhënësit.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mekanizmave kryesor në të cilët shtrihet fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke adresuar edhe rekomandime konkrete, veçanërisht për Inspektoratin e Punës si organi i vetëm shtetëror për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e marrëdhënies së punës si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në fund të raportit do të analizohet korniza legjislativë dhe ajo institucionale e fushës së sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në disa nga vendet e rajonit dhe Evropës.

## Gjendja aktuale e Kornizës Legjislativë

Siguria dhe Shëndeti në Vendin e Punës në Kosovë rregullohet nga një numër i konsiderueshëm i ligjeve, duke filluar nga ligje të përgjithshme deri në ato të veçanta dhe specifike.

Me qëllim të harmonizimit me direktivat e BE-së, korniza legjislativë e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ndër vite ka punuar në drejtim të disa ndryshimeve. Ligjet aktuale që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës synojn një ambient pune të rregullt, në atë mënyrë që të sigurohet që punonjësit të mos bëhen pjesë e aksidenteve.

Siguria dhe Shëndeti në Punë edhe pse në mënyrë jo specifike, në disa nene trajtohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 22 të Kushtetutës theksohet se "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike".<sup>6</sup> Kushtetuta, në nenin 49 përcakton të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit, ku e drejta e punës garantohet dhe se secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.<sup>7</sup> Nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si bazë ligjore e pat Ligji aktual i Punës i miratuar në vitin 2010, i cili me dispozitat ligjore përcakton edhe fushën e mbrotjes në vendin e punës.

Gjithashtu, Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë i miratuar në mënyrë specifike rregullon fushën e lartëcekur. Ndërsa, sa i përket veprimtarisë minerare hyri në fuqi Ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, që qëllim kryesor ka sigurinë në vendin e punës në këtë veprimtari.

<sup>6</sup> "Kushtetuta e Republikës së Kosovës" (2008). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>7</sup> "Kushtetuta e Republikës së Kosovës" (2008). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>





Rrjedhimisht, korniza Legjislative në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës rregullohet nga këto ligje:

- Ligji i Punës
- Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punës
- Ligji për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare
- Ligji për Inspektoratin e Punës.

## LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Nën autoritetin e UNMIK-ut, marrëdhëniet e punës u rregulluan me Rregulloren 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës. Me këtë rregullore ndalohej diskriminimi në punë, përcaktohej mosha minimale për punë, ndalohej puna e detyruar, garantohej e drejta e organizimit sindikal ose formave tjera kolektive dhe marrëveshjet kolektive, definohej marrëdhënia e punës, kontratat e punës dhe format e lidhjes së kontratës, prishja e kontratës së punës, mënyra e marrjes së pagës, orari i punës, pushimi vjetor, festat zyrtare, pushimi i lehonisë, pushimi mjekësor, pushimi pa pagesë ose raste të tjera të pushimit familjar, inspektimi i punës nga organet kompetente, si dhe masat ndëshkuese nëse punëdhënësit nuk i përmbaheshin kësaj rregullore.<sup>8</sup>

Përpyekjet e vazhdueshme për miratimin e një projektligji të punës filluan që nga viti 2006, për t'u finalizuar më pastaj në dhjetor të vitit 2010 me Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës. Ky ligj shfuqizoi rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë të datës 8 Tetor 2001, Ligjin për marrëdhënien e punës të KSA të Kosovës të vitit 1989 dhe Ligjin e Punës së Jugosllavisë të vitit 1977 me amandamentet përkatëse.<sup>9</sup>

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, qëllim thelbësor ka rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës. Vite më vonë me qëllim të plotësisimit të kërkesave nga ana e BE-së si dhe rritjes së efikasitetit të ligjit në fjalë, kanë filluar konsultimet për hartimin e një Ligji të ri të Punës. Me këtë Ligj ndër të tjera përcaktohet edhe Mbrojtja dhe Siguria në Punë, obligimet për punëdhënësin si dhe të drejtat dhe detyrat e punonjësve janë të përcaktuara qartë në nenin 42 të tij.

Me qëllim të rregullimit më të avancuar të Fushës nga Marrëdhënia e Punës gjatë vitit 2018 është hartuar një koncept dokument nga MPMS i cili është miratuar nga Qeveria me datë 26 qershor 2018.<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Rregullore Nr. 2001/27 Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (2001). Marrë nga: [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001\\_27.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_27.pdf)

<sup>9</sup> "Ligji Nr. 03/L-212 i Punës " (2010). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>10</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 06/53 (2018). Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/07/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-53-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2018.pdf>





Në ndryshim-plotësimin e kornizës legjislative të fushës së marrëdhënies së punës është duke u punuar që 3 (tre) vite, përmes Projektligjit të Punës, i cili përveç në Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, është shqyrtuar në lexim të parë edhe në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, mirëpo me rënien e Qeverisë Haradinaj ndër të tjera edhe ky Projektligj mbetet në prag të finalizimit dhe i pamiruar dhe si rrjedhojë është kthyer në pikën zero.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020, Projektligji i Punës ka qenë i paraparë në planin legjislativ. Madje në Qeverinë Hoti është miratuar Projektligji i Punës<sup>11</sup>, mirëpo me rënien e Qeverisë në fjalë përsëri ky projektligj është kthyer në pikën zero, dhe si rrjedhojë ende është në fuqi Ligji i Punës i vitit 2010.

Edhe në qeverisjen aktuale Kurti II, Ligji i Punës zuri vend në Programin Legjislativ të vitit 2021 me afat të miratimit deri në Dhjetor të vitit 2021 mirëpo i njëjti nuk u miratu dhe kaloi në Programin Legjislativ të vitit 2022.<sup>12</sup>

## LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

U miratua në vitin 2013, dhe është në përputhje me Direktivën e BE-së 89/391/KEE të 12 Qershorit 1989. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u shfuqizua Ligji Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës. Ligji aktual në mënyrë eksplicite shfuqizon edhe të gjitha aktet nënligjore të cilat si bazë ligjore e kishin ligjin Nr. 2003/19.

Aprovimi i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në vitin 2013, nënkupton faktin se procesi i përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së filloi edhe para nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) në mes Kosovës dhe BE-së, me të cilën Kosova merr obligime të reja edhe për fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

Me anë të këtij ligji përcaktohen parime të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e rreziqeve që hasen në vendin e punës, detyrimet e punëdhënësit, masat parandaluese me qëllim të eliminimit të faktorëve të rrezikut në vendin e punës. Ligji përmban edhe dispozita të informimit si dhe udhëzime të përgjithshme të cilat si qëllim kanë përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Dispozitat e përfshira në ligj duhet të aplikohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror si dhe lokal. Ligji nuk gjen zbatim në sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forcat e Sigurisë së Kosovës, Policia, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shërbimet për Mbrojtje dhe Shpëtim.

MPMS gjatë vitit 2019 me qëllim të avancimit të legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë hartoi një koncept dokument për avancimin e legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë i cili u miratua nga Qeveria me datë 23 nëntor 2020.<sup>13</sup> Opisoni i rekomanduar

<sup>11</sup> Zyra e Kryeministrit (2020). Raporti i Punës i Qeverisë së Republikës së Kosovës (Qershor-Dhjetor 2020). Marrë nga: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/01/RAPORTI-I-TE-ARRITURAVE\\_09012021\\_ZPS.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/01/RAPORTI-I-TE-ARRITURAVE_09012021_ZPS.pdf)

<sup>12</sup> Programi Legjislativ për vitin 2021. Zyra e Kryeministrit. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/Programi-Legjislativ-per-Vitin-2021...pdf>

<sup>13</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 06/45 (2020). Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/11/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-45-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>





i këtij Koncept Dokumenti është hartimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ky opsion parasheh të përmirësohet dhe avancohet korniza legjislative për të siguruar rregullimin e fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë sipas legjislacionit dhe standardeve të BE-së.<sup>14</sup>

Si bazë ligjore, këtë ligj e patën edhe 22 (njëzet e dytë) akte nënligjore, të miratuara nga MPMS dhe Qeveria e Kosovës me të cilat rregullohen fusha specifike të caktuara me ligj.

## **Fushëveprimi i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në vendin e punës dhe kolizioni me ligjet e tjera**

Neni 2 i Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përcakton se ky ligj zbatohet në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. I vetmi përjashtim nga zbatimi i këtij neni është paragrafi 3 i këtij Ligji i cili përcakton se “Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në sektorët veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forca e Sigurisë së Kosovës, policia, shërbimi i zjarrfikësve dhe shërbimet për mbrojtje dhe shpëtim.”<sup>15</sup> Formulimi i kësaj dispozite lë të nënkuptojë se institucionet ndaj të cilave nuk zbatohet ky ligj janë të numruara në mënyrë taksative, dhe si rrjedhojë, ndaj të gjitha institucioneve tjera ky ligj duhet të zbatohet.

Megjithatë, në vitin 2016 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, fushëveprimtari i të cilit përfshin të gjitha subjektet e licencuara në sektorin minerar. Gjithashtu, në vitin 2018 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, përmban dispozita me të cilat rregullohet çështja e shëndetit dhe sigurisë në punë për aktivitetet që përfshijnë përdorimin e energjisë bërthamore dhe rrezetimit jonizues.

Të dy këto ligje përbëjnë përjashtim nga LSSH, edhe pse ky përjashtim nuk është cekur në mënyrë eksplicite në LSSH. Kjo mund të shkaktojë konfuzitet se cili ligj duhet të zbatohet në këto institucione. Ligji i ri për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë duhet të adresohet ashtu që me këtë ligj të përcaktohet se i njëjti nuk zbatohet për sektorët, fushëveprimtaria e të cilave rregullohet me ligje të veçanta, pa i numëruar se cilët janë këta sektorë. Kjo do të shërbente që në të ardhmen, në rast të nxjerrjes së një ligji të veçantë, të mos paraqitet nevoja për ndryshimin e LSSH-së.

## **Mos harmonizimi i gjobave në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës me Ligjin për Kundërvajtje**

Neni 25 i Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përcakton gjobat për personat fizikë dhe juridikë të cilët nuk i zbatojnë dispozitat e këtij ligji. Ligji përcakton gjoba për

---

<sup>14</sup> Qeveria e Kosovës, Drafti i Dytë i Koncept Dokumentit për Avancimin e Legjislacionit nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. (2019). Marrë nga:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40729>

<sup>15</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.



punëdhënësin që fillojnë nga minimumi pesëqind (500) euro dhe shkojnë deri në maksimumin prej tridhjetë e pesë mijë (35,000) euro.<sup>16</sup> Ndërsa sa i përket të punësuarve, gjobat e parashikuara janë nga 100 deri në pesë mijë (5,000) euro.<sup>17</sup> Këto gjoba nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Kjo pasi që neni 29 i Ligjit për Kundërvajtje përcakton se sanksioni për kundërvajtje për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë më i vogël se 30 euro e as më shumë se 2,000 euro.<sup>18</sup> Ndërsa sa i përket personave juridik, kjo gjobë nuk mund të jetë më e vogël se 500 euro e as më shumë se 20,000 euro<sup>19</sup>.

Gjobat e përcaktuar në Ligjin për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë për punëdhënësit janë në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje kur kemi parasysh përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje, i cili parasheh se gjobat për kundërvajtjet nga fusha e ndër të tjera, sigurisë dhe mbrojtjes në punë, mund të dyfishohet me maksimumin e përcaktuar. Kjo nënkupton se për kundërvajtjet e përcaktuara në LSSH mund të shkojnë deri në maksimumin prej 40,000 euro. Megjithatë, gjobat e përcaktuar me LSSH për të punësuarit (për personat fizik) nuk janë në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje. Kjo pasi që maksimumi i përcaktuar me Ligjin për Kundërvajtje për personat fizik është 2,000 euro, e kur merret parasysh paragrafi 6 i nenit 29 të këtij Ligji, kjo gjobë mund të shkojë në maksimumin prej 4,000 euro. Ndërsa, maksimumi prej 5,000 euro i përcaktuar me LSSH për të punësuarit e tejkalon maksimumin e lejuar nga Ligji për Kundërvajtje.

Është me rëndësi të ceket se Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje është miratuar në shtator të vitit 2016, ndërsa ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017. Edhe pse neni 167 i këtij ligji në mënyrë eksplicite përcakton se të gjitha dispozitat për kundërvajtje që nuk janë në pajtim me këtë ligj duhet të harmonizohen brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji<sup>20</sup>, LSSH nuk është amandamentuar edhe pothuajse 5 vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke bërë që këto dispozita në lidhje me kundërvajtjet të jenë në kundërshtim me Ligjin për Kundërvajtje.

## E drejta e ankesës në lidhje me gjobën

Ligji për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë nuk e përcakton se kush është organi kompetent për shqiptimin e gjobës. E vetmja dispozitë që i referohet kësaj çështje është në nenin 24 të LSSH

<sup>16</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.

<sup>17</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.

<sup>18</sup> Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839>.

<sup>19</sup> Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839>.

<sup>20</sup> Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839>.





ku përcaktohet se mbikëqyrjen e Ligjit e bën Inspektorati i Punës.<sup>21</sup> E kompetencën për shqiptim të gjobave nuk e kishte me asnjë dispozitë ligjore as Inspektorati i Punës me Ligjin Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Megjithatë, në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, i është dhënë kompetencë ekskluzive Inspektorit të Punës që me vendim të shqiptoj gjoba. Në rast të ndryshimit të LSSH-P në të ardhmen, duhet që në mënyrë të qartë të specifikohet kompetenca e organit për shqiptimin e gjobës.

Ligji për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, gjithashtu fare nuk e përcakton as çështjen e ankesës ndaj gjobave të shqiptuara. Ndërsa, Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës edhe pse nuk e përcaktonte kompetencën e inspektorit për të shqiptuar gjoba, megjithatë e përcakton në nenin 6 të drejtën e ankesës kundër vendimit të Inspektorit të Punës. Dispozita e nenit 6 të këtij ligji është e vetmja dispozitë që e rregullon procedurën sipas ankesës, pasi që kjo dispozitë nuk ka qenë subjekt i ndryshimit Ligjit Nr. 03/L-017. Sipas nenit 6 të Ligjit, kundër vendimit të inspektorit të punës mund ti bëhet ankesë autoritetit të Inspektoratit të Punës. Kështu, edhe pse ky ligj e përcakton të drejtën e ankesës, kjo nuk është e mjaftueshëm pasi që nuk është e specifikuar se kush është organi i shkallës së dytë që do të vendos në lidhje me ankesën. Në mënyrë që të ruhet parimi i dyshkallshmërisë, është e nevojshme që në momentin e ndryshimit të Ligji për Inspektoratin e Punës të përcaktohet se kush është organi i shkallës së dytë, kompetent për trajtimin e ankesave.

Megjithatë, edhe pse nuk ka bazë ligjore në praktikë përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave kundër Inspektoratit të Punës i takon Kryeinspektorit të Punës, ku ky i fundit me vendim përcakton Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të përbërë nga tre (3) anëtarë. Shkelje tjetër paraqet fakti se mungesa e burimeve njerëzore brenda Inspektoratit të Punës rezulton që anëtarë të komisionit të jenë edhe ndonja nga inspektorët aktiv në Inspektoratin e Punës.

## **LIGJI Nr. 05/L -062 PËR SIGURI NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE**

Ky ligj u miratua në mars të vitit 2016 dhe ka veprimtari të kufizuar sepse dispozitat e tij shtrijnë fushëveprimin vetëm në sektorin minerar. Fushëveprimtaria e tij zbatohet për të gjitha aktivitetet që përfshijnë hulumtimin, shfrytëzimin ose pasurimin e lëndëve Minerale në Republikën e Kosovës.<sup>22</sup>

“Ky ligj përcakton parime të përgjithshme për parandalimin e rreziqeve në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në sektorin minerar, detyrimet e punëdhënësit, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe personave përgjegjës për sigurinë në punë dhe shëndetin e punonjësve, si dhe vendosë standardet e domosdoshme për sigurinë në punë në aktivitetet minerare. Me këtë ligj

<sup>21</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.

<sup>22</sup> Ligji nr. 05/L -062 Për Sigurinë Në Punë Në Veprimtarinë Minerare. Marrë nga: <https://kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2017/09/LIGJI-P%C3%8BR-SIGURI-N%C3%8B-PUN%C3%8B-N%C3%8B-VEPRIMTARIN%C3%8B-MINERARE.pdf>





synohet përmirësimi sistematik i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë, parandalimi i lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera që ndërlidhen me punën e sektorit minierar”.<sup>23</sup>

Institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik**, zhvillon politikat kombëtare në fushën e minierave dhe mineraleve.
- **Inspektorati i Minierave**, siç u theksua më lartë, është institucion përgjegjës që kontrollon zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare.

Siç u theksua më lartë, fushëveprimtaria e këtij ligji nuk është e përjashtuar nga fushëveprimtaria e LSSH, çka në praktikë shkakton sfidë në implementim.

## LIGJI NR. 2002/9 PËR INSPEKTORATIN E PUNËS

Pas viteve të '90 fusha e inspektoratit të punës është rregulluar me Rregulloren 2001/27 e UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës. Në vitin 2002 duke u mbështetur në rregulloren e lartë cekur hyri në fuqi Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Me anë të këtij ligji përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit e IP-së.

Deri më tani Ligji nuk pati ndonjë ndryshim thelbësor përveç faktit që në vitin 2008 u amandamentua me Ligjin Nr. 03/L-017 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9".<sup>24</sup> Ndryshimet e bëra në këtë ligj, në thelb ishin vetëm ndryshime procedurale dhe jo rrënjësore. Mos-specifikimi i llojeve të inspektimit konsiderohet një ndër problemet kyçe për inspektoratin e punës, ngase duke përmbajtur zbrazëtira të thella juridike e shtynë inspektorin e punës të veprojë në bazë të praktikave të pashkruara.<sup>25</sup> Mos ndarja e llojit të inspektimit me anë të ligjit, ndër të tjera nënkupton se nuk dihet se cilit lloj të inspektimeve duhet dhënë prioritet. Konsiderojmë se inspektimet e rregullta, si dhe inspektimet me këkesë të palës janë një ndër format që rezultojnë me inspektim real të gjendjes në vendin e punës, ngase punëdhënësi nuk do ketë mundësi të përgatitet paraprakisht.

Me ndryshimin e ligjit në vitin 2008 nuk kemi specifikim të kompetencave të Kryeinspektorit, të zëvendës kryeinspektorëve, nuk ceken kriteret profesionale për inspektorë të punës, nuk paracaktohen kushtet për pranimin dhe vlerësimin e inspektorëve, si dhe shumë zbrazëtira të tjera me të cilat ballafaqohet Inspektorati i Punës si mekanizmi i vetëm shtetëror për mbikëqyrjen

<sup>23</sup> Ligji nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12324>

<sup>24</sup> Ligji nr. 03/L-017 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës (2008). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2581>

<sup>25</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2020). Analiza e Projektligjit të Inspektoratit të Punës. Marrë nga: [https://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2020/11/LigjiperInspektorattePunes\\_Final-ALB.pdf](https://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2020/11/LigjiperInspektorattePunes_Final-ALB.pdf)





e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore relevante që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës si dhe me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.<sup>26</sup>

Projektligji për Inspektoratin e Punës ishte pjesë e Planit Legjislativ të Qeverive që nga viti 2017. Pas shumë përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e MPMS-së, me datë 28 gusht 2020 nga Qeveria u aprovua Projektligji për Inspektoratin e Punës.<sup>27</sup> Megjithatë, ky ligj nuk arriti të miratohet në Parlament për shkak të qeverisjesë jetëshkurtër.

Projektligji për Inspektoratin e Punës ishte pjesë edhe e Programit Legjislativ 2021, mirëpo u tërhoq gjatë muajit Tetor<sup>28</sup>.

Për më tepër, ndryshimin e kornizës legjislative të Ligjit për Inspektoratin e Punës e konsideruan si shumë të rëndësishëm më shumë se gjysma e numrit aktual të inspektorëve/eve të punës të cilët morrën pjesë në plotësimin e një pyetësori në lidhje me kornizën institucionale të fushës së sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës<sup>29</sup>.

## Fushëveprimi i Ligjit për Inspektoratin e Punës

Neni 1 i Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës përcakton fushëveprimin e Ligji, i cili shtrihet në të gjitha vendet e punës, pavarësisht se cilat dispozita ligjore janë në fuqi e që kanë të bëjnë me kushtet e punës mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve. Ky ligj nuk përmban përjashtim e përcaktuar në nenin 2 paragrafi 3 të LSSH-së, i cili i përjashton nga fushëveprimi disa sektorë. Kjo do të thotë që Ligji për Inspektoratin e Punës zbatohet në të gjitha sektorët pa përjashtim, duke përfshirë edhe sektorët e përjashtuar nga LSSH-ja, çka e bën të vështirë zbatimin e tij në këto sektorë. Megjithatë, sfidë më e madhe e zbatimit të këtij ligji është në sektorët në të cilët LSSH-ja nuk zbatohet si dhe në sektorët të cilët nuk janë në mënyrë eksplicite të përjashtuara nga LSSH-ja por që janë të rregulluara me ligje të veçanta. Konkretisht, këta sektorë përfshijnë veprimtaritë minerare si dhe veprimtaritë e rregulluara me Ligji Nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore. Kjo pasi që përgjegjës për zbatimin e këtyre ligjeve janë institucione tjera e jo Inspektorati i Punës.

Kështu, në nenin 13.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare përcaktohet se Inspektorati i Minerave është i autorizuar që të përcaktojë masat e sigurisë në rast rreziku për jetën, shëndetin e njerëzve dhe ambientin e punës. Gjithashtu, neni 44 i Ligjit 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore i jep kompetencë Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore për të bërë inspektime në lidhje

<sup>26</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2020). Analiza e Projektligjit të Inspektoratit të Punës. Marrë nga: [https://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2020/11/LigjiPerInspektoratePunes\\_Final-ALB.pdf](https://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2020/11/LigjiPerInspektoratePunes_Final-ALB.pdf)

<sup>27</sup> Qeverisë e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 05/28 (2020). Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/08/Vendimet-nga-mbledhja-e-28-t%C3%AB-e-Qeverise%C3%AB.pdf>

<sup>28</sup> Zyra e Kryeministrit. Vendim Nr. 02/42 për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2021. Marrë nga: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/10/Vendimet-e-Mbledhjes-se-42-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves.pdf>

<sup>29</sup> Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të Fushës së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.





me sigurinë dhe shëndetin në punë në sektorët të cilët mbulohen nga ky Ligj. Për më tepër, të dy këto ligje i japin të drejtë Inspektoratit të Minierave dhe Agjencisë respektivisht, që të shqiptojnë gjopa për moszbatim të këtyre ligjeve. Kjo shkakton paqartësi në fushëveprimin e Ligjit për Inspektoratin, pasi që ky ligj nuk i përjashton këta sektorë nga fushëveprimi. Në rast të ndryshimit të Ligji për Inspektoratin e Punës, duhet të specifikohen sektorët në të cilët Inspektorati i Punës nuk ka kompetencë të inspektimit në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.

## Institucionet Përgjegjëse në Fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Akter kryesor në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë janë: Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, Inspektorati i Minierave dhe Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet.

### Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

Në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve (referuar si MFPT në vazhdim), vepron Departamenti i Punës dhe Punësimit, Divizioni i Marrëdhënieve të Punës, Dialogut Social, Shëndetit dhe Sigurisë në Punë i cili është përgjegjës për hartimin e politikave nga marrëdhënia e punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjithashtu, Ministria është përgjegjëse që në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës të hartoj Programin Zhvillimor të Inspektoratit të Punës, ku vendosen objektiva specifike të cilat duhet realizuar brenda periudhave të caktuara.

Gjithashtu, me hartimin e politikave vendosen standarde adekuate në përputhje me ato ndërkombëtare të cilat ndikojnë pozitivisht në fushën e lartëpërmendur. Standarde këto që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të punës, zvogëlimin e punësimit informal dhe fuqizimin e mekanizmave mbikëqyrës.

MFPT, me anë të hartimit të politikave, synon avancimin në fushën e marrëdhënies së punës, si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë, në mënyrë që të arrihet përmbushja e obligimeve të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit.

Në divizionin e lartëcekur me qëllim të përmbushjes së detyrave janë të punësuar katër (4) zyrtarë duke përfshirë këtu edhe Udhëheqësen e Divizionit. Konsiderohet se numri ideal për të përmbushur detyrat që i përkasin këtij divizionit do të ishte dhjetë (10) zyrtarë<sup>30</sup>.

Kapacitetet e ulëta njerëzore në krahasim me detyrat dhe përgjegjësitë e divizionit përkatës nga njëra anë dhe ndryshimet e shpeshta të qeverive nga ana tjetër janë dy nga sfidat kyçe të cilat e vështirësojnë punën e këtij divizionit duke ndikuar drejtpërdrejt në objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë si dhe duke krijuar ngërç në ligje dhe strategji për vite me radhë.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> Ahmeti, Leunora. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Intervistë.

<sup>31</sup> Ahmeti, Leunora. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Intervistë.







Për më tepër, shkrirja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në MFPT paraqet sfidë të veçantë, pasi që ende nuk është i qartë funksionimi i brendshëm. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende nuk ka miratuar rregulloren e re për organizimin e brendshëm, ku do të përfshinte edhe Departamentet dhe Divizionet e bartura nga MPMS. Duke qenë se që nga vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, është e nevojshme që të miratohet rregullorja e re e organizimit të brendshëm të MFPT. Për më tepër, Rregullorja (QKR) Nr. 01/2020 për Standardet e organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, e cila rrjedh nga Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore, obligon të gjitha institucionet e administratës shtetërore që brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore të nxjerrin rregulloret e reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.<sup>32</sup> Edhe pse kjo rregullore ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019, MFPT ende nuk ka nxjerrë rregulloren e re. Rekomandohet që sa më parë MFPT të nxjerr rregulloren për organizimin e brendshëm për tu harmonizuar me këtë ligj, por edhe që të sistematizohen strukturat e bartura nga MPMS.

## Inspektorati i Punës

Inspektorati i Punës (referuar me IP në vazhdim) si organ ekzekutiv u themelua në vitin 2002, në përputhje me ligjin 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë. Ky organ u themelua në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në atë kohë, tani MFPT) si organ i pavarur i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së kornizës legjislative në fushën e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë.

IP shtrinë fushëveprimin e tij në të gjitha vendet e punës në tërë territorin e Kosovës, pavarësisht se cilat dispozita ligjore janë në fuqi që kanë të bëjnë me kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve në përgjithësi.<sup>33</sup>

Autoriteti më i lartë është Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, i cili emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrit/es së Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve pas përfundimit të një procedure konkurrimi të hapur bazuar në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë. Kandidati për Kryeinspektor duhet të ketë Diplomë Universitare, tetë (8) vite përvojë punë, pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale.

Në anën tjetër, gjithashtu edhe të gjitha pozitat në Inspektoratin e Punës rekrutohen duke u bazuar në nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë. Për pozitat tjera udhëheqëse siç është pozita e Udhëheqësit të Divizionet për Koordinim Rajonal, kërkohet Diplomë universitare nga fusha e shkencave juridike apo teknike, 5 vite përvojë pune profesionale. Ndërsa për pozitën Inspektor i

<sup>32</sup> Rregullore (QRK) Nr. 01-2020 për Standardet e organizimit të Brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27043>

<sup>33</sup> Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoriatin e punës, (2002). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3252>





Punës kërkohet diplomë universitare në fakultetin juridik ose shkenca teknike si dhe tre (3) vite përvojë pune profesionale.

Inspektorati i Punës për punën e tij harton dhe publikon raport të përgjithshëm vjetor. Që nga viti 2016 ku u funksionalizua faqja zyrtare e Inspektoratit të Punës, vetëm gjatë vitit 2017 dhe 2018 IP publikoj raport për tre (3) mujorshin e parë të vitit, ndërsa më tutje raportimi ishte vjetor dhe për më tepër gjatë vitit 2019 në faqën zyrtare të IP-së nuk figuron fare raporti vjetor.

Gjithashtu, raportet vjetore deri në vitin 2020 përmbanin vetëm të dhëna statistikore, ku vlen të përmendet se çdo vit ka pasur mospërputhje në statistikat e publikuara. Raporti vjetor i publikuar për vitin 2020 ishte më përmbajtësorë në krahasim me raportet e mëparshme.

Njësoj sikurse tek MFPT, edhe Inspektorati i Punës duhet që sa më parë të nxjerr rregulloren e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në mënyrë që strukturat e brendshme të jenë në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

### Gjendja aktuale e IP-së

Inspektorati i Punës momentalisht udhëhiqet nga një ud. Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës. Inspektorati i Punës përbëhet nga: Kryeinspektor, Zëvendës Kryeinspektor si dhe Inspektorët. Zyra e Kryeinspektorit përbëhet nga: Kryeinspektor i Punës; Zëvendës Kryeinspektor i Punës për Marrëdhënie në Punë; Zëvendës Kryeinspektor i Punës për Siguri në Punë; Zëvendës Kryeinspektor i Punës për Shëndet në Punë; dhe Personeli mbështetës.<sup>34</sup>

Konform respektimit hierarkik, Kryeinspektor i raporton në mënyrë direkte Ministrit të Financave Punës dhe Transfereve ndërsa Zëvendës Kryeinspektorët i raportojnë Kryeinspektorit.

Ligji nuk përcakton numrin e inspektorëve në IP, ndërsa aktualisht janë vetëm 31 inspektorë aktiv, prej tyre vetëm 8 janë gra. Për nga profesioni njëzet e katër (24) janë juristë, katër (4) janë inxhinierë, dy (2) janë ekonomistë, dhe një (1) nga fushat tjera. Inspektorët nuk janë të specializuar për fushat përkatëse të sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe në marrëdhënien juridike të punës.

Rrjedhimisht, puna në Inspektoratin e Punës nuk është e para-profilizuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës dhe në fushën e marrëdhënies së punës. Kjo bënë që inspektorët që janë me profesion juristë të inspektojnë fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës ndërsa inspektorët me profesion inxhinierë të inspektojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Sa i përket pjesës së organizimit të brendshëm, puna në Inspektoriatin e Punës është e ndarë në departamente dhe divizione të veçanta; si:

1. "Departamenti për Politika, Planifikim dhe Çështje ligjore;
2. Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;

<sup>34</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2015), Rregullore (QRK) Nr. 15/2015 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoriatin e Punës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11275>







- 2.1 Divizioni për Burime Njerëzore;
- 2.2 Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- 2.3 Divizioni për TI dhe Shërbime Logjistike.
3. Divizioni i Prokurimit.<sup>35</sup>

Puna në IP është e ndarë edhe në divizione rajonale, si vijon:

1. "Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Prishtinës;
2. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Mitrovicës;
3. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Pejës;
4. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Gjakovës;
5. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Prizrenit;
6. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Ferizajt;
7. Divizioni i Koordinimit në Rajonin e Gjilanit".

### Sfidat e Inspektoratit të Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kornizës Legjislative të Punësimit

Zbatimi i ulët i kornizës legjislative të punësimit në vendin tonë tashmë është evident. Në një raport të publikuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) për "Monitorimin e Zbatimit të Ligjit të Punës në Kosovë" ku u anketuan katërqind (400) kompani të sektorit privat me shtrirje në tërë Kosovën, del se:

- Paraja e gatshme vazhdon të jetë formë e pagesës për 34% të punëtorëve;
- 52,4% e bizneseve aplikojnë kontrata me afat të kufizuar;
- 26% të punëtorëve nuk u lejohet e drejta për pushim vjetor me pagesë;
- Pushimi i lehonisë nuk aplikohet për 45% të grave, ndërsa 31% e grave nuk e shfrytëzojnë këtë të drejtë me vetëdëshirë;
- 56% e punëtorëve punojnë jashtë orarit të punës,
- 83% e bizneseve kërkojnë nga punëtorët që të punojnë së paku një ditë gjatë fundjavës.
- 53% e bizneseve nuk kanë person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës<sup>36</sup>.

Nga ana tjetër, Inspektorati i Punës si organi i vetëm brenda pushtetit ekzekutiv përgjegjës për monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e marrëdhënieve të punës si dhe sigurisë e shëndetit në punë, has në mungesën e kushteve elementare që ndikojnë në mos përmirësimin e zbatimit të kornizës legjislative.

Në kushtet bazë hyn mungesa e burimeve njerëzore të IP-së, dhe mungesa e kushteve teknike.

<sup>35</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2015), Rregullore (QRK) Nr. 15/2015 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në inspektoriatin e punës. Marrë nga:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11275>

<sup>36</sup> Iniciativa Kosovare për Stabilitet, (2021). Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Ligjit të Punës në Kosovë. Marrë nga: <https://iksweb.org/wp-content/uploads/2022/01/Microsoft-Word-Monitorimi-i-bizneseve-Final.docx.pdf>





Nëse shikohet numri aktual i inspektorëve në raport me numrin e të punësuarëve i bie që është një (1) inspektor për mbi (dhjetë mijë) 10.000 të punësuar, numër ky i pamjaftueshëm për arritjen e objektivave që ka ky institucion, që është inspektimi në vendet e punës dhe ofrimi i këshillave për të gjithë punonjësit dhe punëdhënësit së paku një herë në vit. Rritja e numrit të inspektorëve është rekomanduar edhe nga Komisioni Evropian përmes raporteve vjetore që ky i fundit përpilon për Kosovën. Përkundër kësaj Inspektorati i Punës, në praktikë vitet e fundit është ballafaquar me një rënie të dukshme të numrit të inspektorëve, gjë që ka ndikuar në mos-efikasitetin e punës të këtij organi si dhe në shkallën e ulët të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në përgjithësi.

Tabela e mëposhtme parqet numrin e bizneseve aktive të ndara në rajone si dhe numrin e inspektorëve aktivë në Inspektoratin e Punës sipas rajoneve.

Kushtet e vështira teknike me të cilat vepron inspektorati i punës, paga e ulët në krahasim me detyrat dhe përgjegjësitë, vëllimi i lartë i punës për një inspektor, menaxhimi i dobët, gjithashtu pensionimi i disa inspektorëve, numër ky i cili nuk u plotësua me inspektorë të rinj janë ndër arsyt kryesore që çuan në uljen e numrit të inspektorëve.

	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Gjakovës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Ferizajit	Rajoni i Gjilanit
Numri i bizneseve aktive	64,836	14,589	13,289	14,444	17,508	17,645	17,966
Numri i Inspektorëve në Inspektoratin e Punës	13	6	3	3	4	5	5

Për më tepër, numri i vogël i inspektorëve ndikon që në rajonin e Pejës dhe Gjakovës në shumicën e inspektimeve të marrë pjesë vetëm një (1) inspektor dhe ky fakt e vë në diskutim objektivitetin gjatë procesit të inspektimit.<sup>37</sup> Ndërsa në pyetjen drejtuar të gjithë inspektorëve të rajoneve përkatëse, se sa inspektorë preferohet të marrin pjesë në një inspektim, 70% prej tyre u përgjigjen se duhet të jenë dy (2) inspektorë.<sup>38</sup>

Kështu, mbi 90% e numrit aktual të inspektorëve e konsiderojnë si shumë të rëndësishme rritjen e numrit të inspektorëve.

<sup>37</sup> Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

<sup>38</sup> Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.





Rritja e numrit të inspektorëve është përcaktuar si objektive edhe në Programin e Qeverisjes aktuale.<sup>39</sup> Për më tepër qeverisja aktuale ka premtuar pesëfishimin e numrit të inspektorëve të punës.

Në anën tjetër, 48% e inspektorëve aktualë të punës konsiderojnë se numri ideal i inspektorëve do të ishte 100-150, ndërsa 33% vlerësojnë se duhet të jenë më shumë se 150 inspektorë, përqindja tjetër konsideron se përmbushja e nevojave të Inspektoratit të Punës është ideale me një numër prej 60-80 inspektorë.<sup>40</sup>

Gjithashtu, mbi 95% e numrit aktual të inspektorëve konsiderojnë se rritja e numrit të inspektorëve do të nënkuptonte rritje të numrit të inspektimeve dhe rritje të cilësisë në punë të IP-së në përgjithësi.<sup>41</sup>

Ndër të tjera edhe rritja e numrit të stafit administrativ u pa si shumë e rëndësishme nga mbi 95% e inspektorëve aktual në IP, kjo për arsye se edhe punët administrative mbulohen nga inspektorët e punës,<sup>42</sup> gjë që i privon ata nga realizimi i më shumë inspektimeve.

Vlen të theksohet se Inspektorati i Punës ende nuk ka përmbushur edhe rekomandimet e Auditorit të Brendshëm për Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës të vitin 2020 si dhe 2021, ku është kërkuar caktimi me aktemërim i një zyrtari të shërbimeve logjistike. Kjo për arsye të "shpenzimeve shumë të larta të derivateve të naftes pa arsyetim me kilometrat e kaluara, përdorimi i automjeteve zyrtare jo në përputhje me kriteret dhe shpenzimi i parasë publike i pa arsyetuar me dëshmi të mjaftueshme".<sup>43</sup>

Nga ana tjetër, përveç kapaciteteve të ulëta profesionale, është evidente mungesa e kushteve teknike në kuadër të IP-së, kushtet ndryshojnë nga rajoni në rajon, por thelbi mbetet i njëjtë. Me përjashtim të Rajonit të Prishtinës i cili ka një kompani të kontraktuar për mirëmbajtjen e zyrave, inspektorët e rajoneve të tjera merren edhe me mirëmbajtjen.

Rrjedhimisht të gjithë inspektorët (gjithsej 32 që marrin pjesë në plotësimin e pyetësorit) e vlerësuan si shumë të rëndësishëm avancimin e kapaciteteteve teknike me të cilat operon Inspektorati i Punës<sup>44</sup>.

---

<sup>39</sup> Zyra e Kryeministrit. Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025, (2021). Marrë nga: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

<sup>40</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2021). Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

<sup>41</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2021). Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

<sup>42</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2021). Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

<sup>43</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqeniesë Sociale, (2020). Raporti Final i Auditimit, Të hyrat Divizioni i Logjistikës dhe Infrastrukturës.

<sup>44</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2021). Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.





Vlen të theksohet se brenda inspektoratit të punës mungon edhe bashkëpunimi i mirëfilltë kolegial, ku 75% e numrit të inspektorëve aktual e konsiderojnë si sfidë kryesore me të cilën ballafaqohen mungesën e bashkëpunimit të duhur brenda inspektoratit të punës.<sup>45</sup>

## Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë

Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë (referuar si KNSSHP në vazhdim), për bazë ligjore ka nenin 4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.<sup>46</sup> KNSSHP-ja është themeluar në vitin 2016 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

KNSSHP, përcjellë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarëve, harton politika për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe i propozon Qeverisë rekomandime. Përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, 3 (tre) përfaqësues të Qeverisë, 2 (dy) përfaqësues të punëdhënësve, 2 (dy) përfaqësues të punëtorëve, 2 (dy) ekspertë nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, 1 (një) ekspert i mjekësisë së punës dhe 1 (një) ekspert ad-hoc, varësisht nga natyra e çështjes.<sup>47</sup>

Bashkëpunimi i KNSSHP dhe MPMS, shihet si shumë i nevojshëm me qëllim që të shkëmbejnë informacione konkrete mbi gjendjen aktuale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

## Inspektorati i Minierave

Inspektorati i Minierave, (referuar me IM në vazhdim) fillimisht kishte bazë ligjore Rregulloren e UNMIK-ut 2005/2 mbi Themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë, pastaj Ligjin Nr. 03/L-081 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në Kosovë të vitit 2008, dhe krejt në fund Ligjin Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Mineralet me të cilin u shfuqizuan të gjitha rregulloret dhe ligjet paraprake.

Inspektoriati i Minierave është institucion përgjegjës për kontrollimin e zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare. Vepron si departament në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (referuar si KPMM në vazhdim), si dhe ushtron funksionet dhe kompetencat në pajtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Specifikisht, Inspektorati i Minierave është përgjegjës për inspektimin e aktiviteteve të hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta të cilitdo person për të konstatuar nëse personi i cili ushtron këto aktivitete posedon licencë ose leje të dhënë nga KPMM-ja dhe për të konstatuar nëse aktivitetet janë duke u ushtruar në përputhje me licensën ose leje përkatëse dhe

---

<sup>45</sup> Qendra për Politika dhe Avokim, (2021). Pyetësor në lidhje me Kornizën Institucionale të fushë së Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës.

<sup>46</sup> Ligji 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, (2013). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>

<sup>47</sup> Ligji 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, (2013). Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>





rregulloret zbatuese të sigurisë dhe mjedisore të nxjerra nga Ministria në përputhje me ligjin e minierave.<sup>48</sup>

## Organizmi i Inspektoriatit të Minierave

IM udhëheqet nga Kryeinspektori, i cili emërtohet nga bordi i KPMM-së dhe i raporton këtij të fundit.

Në IM janë të punësuar gjithësej njëzet e tre (23) inspektorë/e dhe dy zyrtarë për çështje administrative. Sipas pozitës dhjetë (10) inspektorë të xehtarisë (duke mos përfshi kryeinspektorin), pesë (5) inspektorë gjeolog dhe një (1) inspektore gjeologe, katër (4) inspektorë elektro makineri, një (1) inspektore për kontrollë kualiteti<sup>49</sup>.

Më tutje inspektorët për punën e tyre raportojnë tek Kryeinspektori.

Inspektoriatit i Minierave, mbikëqyrë gjithë territorin e Republikës së Kosovës, të ndarë në rajone, si vijon:

- Rajoni i Prishtinës;
- Rajoni i Prizrenit;
- Rajoni i Pejës;
- Rajoni i Gjilanit;
- Rajoni i Mitrovicës.

Konsiderohet se shtimi i tre rajoneve të tjera është i nevojshëm për të mbuluar sa më mirë punën e sigurisë në veprimtarinë minerare, po ashtu konsiderohet e nevojshme rritja e numrit të inspektorëve të minerave edhe për gjashtë (6) inspektorë<sup>50</sup>.

IM, monitoron në mënyrë të pavarur këto aktivitete:

- Hulumtimi, shfrytëzimin dhe aktivitetet e veçanta të resurseve minerale në Republikën e Kosovës;
- Vlerësimin e mineraleve të shfrytëzuara nga minierat dhe guroret për kalkulimin e Rentës Minerare;
- Zbatimin e masave të sigurisë e mbrojtjes në punë;
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimtarinë minerare;
- Inspektimet e lëndimeve me fatalitet (vdekjeprurëse) dhe lëndimeve të rënda, si dhe dëmet mjedisore ose dëmtimi i pronës dhe masat të cilat është e nevojshme të ndërmerren;
- Inspektimet e fushave paraminuese për minim masiv të përgatitura sipas projektit të shfrytëzimit, për të konstatuar përputhshmërinë e parametrave teknik në aplikim;

---

<sup>48</sup> Ligji Nr. 03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet, (2010). Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2702>

<sup>49</sup> Gashi, Jahir. Inspektorati i Minierave. Intervistë.

<sup>50</sup> Gashi, Jahir. Inspektorati i Minierave. Intervistë.





- Inspektimet e minimimit dhe marrja e masave për minim të sigurt duke i zbatuar të gjitha masat e sigurisë dhe rregullat e parapara për minim masiv;
- Lëshimi i lejeve për transfer të eksplozivit nga depot kryesore të eksplozivit të minierave nëntokësore dhe mirëmbajtja e shënimeve për gjendjen e sasisë së eksplozivit;
- Inspektimet e rregullta në minierat nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe objektet për përpunimin e pasurimit e lëndës së parë minerale;
- Inspektimet e rregullta vjetore të ndërmarrjeve të licencuara sipas UA.Nr.02/2016 (për mbikqyrjen dhe inspektimin e bartësve të licensave që ushtrojnë aktivitetet minerar);
- Ndërprerja e aktiviteteve minerare nëse këto aktivitete nuk kryhen në pajtim me ligjet, rregulloret, dispozitat ligjore, standardet dhe normativet teknike;
- Inspektimet e aktiviteteve minerare të jashtëligjshme dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e tyre;
- Koordinimi i inspektimit me institucionet tjera".<sup>51</sup>

### Gjendja aktuale e sigurisë dhe shëndetit në punë në veprimtarinë minerare

Në veprimtarinë minerare kemi një numër të lartë të aksidenteve në vendin e punës ndër vite, gjë që tregon shkallën e ulët të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në këtë veprimtari. Vetëm gjatë vitit 2019, tetëdhjetë e tre (83) punonjës kanë pësuar aksidente në vendin e punës dhe tre (3) prej tyre kanë pësuar me fatalitet<sup>52</sup>.

Në Raportin Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale si shkaktarë më të shpeshtë të aksidenteve në vendin e punës konsiderohen:

- Gjendja jo e mirë teknike e pajisjeve dhe stabilimenteve tekniko – teknologjike dhe manipulimi jo adekuat me këto stabilimente;
- Gjendja e shkallëve në minierat sipërfaqësore (këndet dhe lartësitë e shkallëve punuese dhe këndi gjeneral);
- Pakujdesia dhe neglizhenca e punëtorëve;
- Përdorimi i pamjaftueshëm i mjeteve personale mbrojtëse;
- Mungesa e njohurive dhe aftësimi i pamjaftueshëm profesional".<sup>53</sup>

Vlerësohet se niveli i ulët i sigurisë në punë, në veprimtarinë minerare, është si rezultat i pamjaftueshmërisë së numrit të inspektorëve, ngase pamundësohet përcjellja e zbatimit të ligjit për Sigurinë në Punë në Veprimtarinë Minerare. Ndër të tjera theksohet se Inspektorati i

---

<sup>51</sup> Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, (2020) Raporti Vjetor Për Vitin 2019. Marrë nga: [https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor\\_KPMM\\_2019-shq.pdf](https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf)

<sup>52</sup> Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, (2020) Raporti Vjetor Për Vitin 2019. Marrë nga: [https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor\\_KPMM\\_2019-shq.pdf](https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf)

<sup>53</sup> Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, (2020) Raporti Vjetor Për Vitin 2019. Marrë nga: [https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor\\_KPMM\\_2019-shq.pdf](https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf)



Minierave për aksidentet në vendin e punës njoftohet vetëm në ato raste kur aksidentet janë të rënda dhe fatale.<sup>54</sup>

Duhet theksuar se të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit vendosin në pah se Inspektorati për Miniera dhe Minerale si departament në KPMM, nuk ka bërë mjaftueshëm për të mbajtur përgjegjës Operatorin Ekonomik (referuar si OE në vazhdim) që të respektojë rregullat dhe kriteret ligjore si dhe të rikultivojnë/rehabilitojnë zonën e dëmtuar ku janë shfrytëzuar mineralet si nga OE-të legal ashtu edhe ata ilegal.<sup>55</sup> Madje, Auditori ka identifikuar edhe raste konkrete në të cilat Inspektorati nuk ka vepruar në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Kjo do të thotë që ka pasur shkelje të Ligjit nga vetë Inspektorët.<sup>56</sup> Kështu në një rast konkret gjatë vitit 2019, ku rreziku në vendin e punës ishte i pranishëm, inspektorati vetëm ka shqiptuar vërejtje duke mos i pezulluar punimet ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Miniera dhe Minerale në raste të tilla.<sup>57</sup> Ndërsa edhe në një rast tjetër pothuajse të ngjashëm me atë paraprak, ku rrezikohej jeta e punonjësve pasi që kishte të bënte me mungesën e udhëzimeve për punë të punonjësve, mungonin kualifikimet e punonjësve për vendet e punës, mungonin mjetet mbrojtëse, mungonte kontrollimi i mekanizmit, gjendja teknike e mjeteve të punës etj., Inspektorati nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore ku parashihet pezullimi i punimeve por është shqiptuar vetëm vërejtje.<sup>58</sup>

Në këtë formë i bie që krahas shkeljes së Ligjit për Miniera dhe Minerale, kemi shkelje edhe të Ligjit për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, nga ana e Inspektoratit të Minierave i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të po këtyre dy ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë si bazë ligjore, ligjet në fjalë. Kjo është shumë shqetësuese ngase në këtë mënyrë nuk kemi zbatim të ligjeve e kjo ndër të tjera e ul dukshëm shkallën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

Gjithashtu, edhe në këtë veprimtari inspektimit e jashtëzakonshme nuk gjenin zbatim fare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit.<sup>59</sup>

---

<sup>54</sup> Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, (2020) Raporti Vjetor Për Vitin 2019. Marrë nga: [https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor\\_KPMM\\_2019-shq.pdf](https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2020/10/Raporti-vjetor_KPMM_2019-shq.pdf)

<sup>55</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. (2020). Raport i Auditimit për Përformancën e KPMM. Marrë nga: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/Raporti-auditimit-mineralet-ndertimore-2020-Shqip.pdf>

<sup>56</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. (2020). Raport i Auditimit për Përformancën e KPMM. Marrë nga: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/Raporti-auditimit-mineralet-ndertimore-2020-Shqip.pdf>

<sup>57</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. (2020). Raport i Auditimit për Përformancën e KPMM. Marrë nga: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/Raporti-auditimit-mineralet-ndertimore-2020-Shqip.pdf>

<sup>58</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. (2020). Raport i Auditimit për Përformancën e KPMM. Marrë nga: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/Raporti-auditimit-mineralet-ndertimore-2020-Shqip.pdf>

<sup>59</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. (2020). Raport i Auditimit për Përformancën e KPMM. Marrë nga: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/12/Raporti-auditimit-mineralet-ndertimore-2020-Shqip.pdf>



## Mungesa e bashkëpunimit mes Inspektorateve

Mungesa e një baze unifikuese ligjore për inspektoratet në Kosovë vendosë në pah kontradikta të konsiderueshme institucionale, veçanërisht në ato inspektorate që kanë qëllime të ngjajshme. Kështu, Inspektorati i Punës dhe Inspektorati i Minierave nuk kanë koordinim mes vete sa i përket publikimit të statistikave të unifikuara mbi numrin e aksidenteve në vendin e punës, që do të thotë se në fund nuk dihet saktë numri total i aksidenteve në vendin e punës në nivel vendi. Një mos unifikim i këtyre statistikave na dërgon edhe në konstatim jo të drejtë të shkallës së sigurisë dhe shëndetit në mbarë vendin për arsye se numri i aksidenteve në vendin e punës pasqyron shkallën e sigurisë dhe shëndetit të një vendi.

Meqenëse rastet e aksidenteve në veprimtarin minerare, nuk janë në kontrollin e drejtëpërdrejtë të Inspektoratit të Punës, rekomandohet që Inspektorati i Punës të i konfirmojë rastet e aksidenteve të cilat ndodhin në punë edhe në veprimtarin minerare mirëpo verifikimi i kushteve të sigurisë dhe shëndetit në këtë veprimtari të kryhet nga Inspektorati i Minierave.

Një praktikë e tillë do të mundësonte një konstatim më të saktë të shkallës së sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

## Harmonizimi i legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë me legjislacionin e BE-së

Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e punësimit si pikënisje ka Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (referuar me MSA në vazhdim) ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian e cila hyri në fuqi në vitin 2016. Nenet 82 dhe 106 të MSA-së synojnë të mbështesin Kosovën në reformimin e politikave të punësimit, shëndetit dhe sigurisë në punë, përafrimin e kornizës legjislative me atë të BE-së dhe në krijimin e mundësive të barabarta.<sup>60</sup>

Korniza Legjislative aktuale në fushën sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës ka shënuar progres në përafrimin me acquis të BE-së, mirëpo me qëllim të transpozimit të plotë të Direktivës 89/391/KEE e Këshillit Evropian e datës 12 qershor 1989 mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë (Direktiva Kornizë) është paraparë nga MPMS Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit aktual.<sup>61</sup>

Qeveria e Kosovës me qëllim të zbatimit të MSA-së çdo vit harton Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (referuar me PKZMSA në vazhdim). Në PKZMSA Qeveria cakton aktivitete të cilat do t'i realizoj gjatë vitit me qëllim të zbatimit të MSA-së. Këto aktivitete ndahen në dy grupe kryesore: në masa legjislative dhe masa zbatuese.

<sup>60</sup> Bashkimi Evropian, (2015). Marrëveshja e Stabilizim Asocimit Njëpërmjet Kosovës në njërën anë dhe Bashkimit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër. Marrë nga:

[https://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo-eu\\_saa\\_final\\_sq.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo-eu_saa_final_sq.pdf)

<sup>61</sup> Qeveria e Kosovës, (2019). Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) 2019 – 2023. Marrë nga: [https://www.mei-](https://www.mei-ks.net/repository/docs/20190510083007_pkzmsa_2019-2023_final.pdf)

[ks.net/repository/docs/20190510083007\\_pkzmsa\\_2019-2023\\_final.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/20190510083007_pkzmsa_2019-2023_final.pdf)





PKZMSA është e ndarë në 35 kapituj të acquis-së, të cilët përfshijnë të gjitha fushat në të cilat duhet të bëhet përafrimi i legjislacioneve. Në kapitullin e 19 të acquis-së zënë vend Politikat Sociale dhe Punësimi, ku çdo vit propozohet masa për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në në fushën e punës, barazisë, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Gjithashtu, me qëllim të matjes së nivelit të zbatueshmërisë së PKZMSA-së, çdo vit, Qeveria harton Raportin për implementimin e PKZMSA-së gjatë atij viti dhe del me të dhëna statistikore sa i përket zbatueshmërisë së tij.

Nëse ndër vite analizohen këto raporte, vërehen vonesa serioze në përafrimin e legjislacioni nga ky kapitull. Vetëm gjatë vitit 2020, 57.14% e masave të planifikuara në PKZMSA në kuadër të kapitullit 19 të acquis-së nuk janë zbatuar.<sup>62</sup> Ndërsa në vitin 2019, përqindja e zbatueshmërisë ishte edhe më e ulët, me 62.50% e masave të planifikuara në PKZMSA në kuadër të kapitullit 19 të acquis-së të pazbatuara.<sup>63</sup>

Si rrjedhojë e kësaj, Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën, ndër vite e kanë parë si shqetësuese sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës në Kosovë. Rekomandimet konkrete të dalta nga Raportet e KE-së për Kosovën, siguruan përafrim të kufizuar të kornizës legjislative në fushën e lartëpërmendur. Bazuar në këto rekomandime ndër vite, është miratuar Ligji aktual i Punës, i cili edhe pse forcoi kornizën ligjore në fushën e punës, u konsiderua se arrititi vetëm progres të kufizuar në përafrim. Kjo pasi që kërkohet që Kosova të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis-në e BE-së, duke përfshirë edhe rregulla të BE-së mbi mosdiskriminimin në baza gjinore në procesin e punësimit si dhe pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror.<sup>64</sup>

Me miratimin e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë në vitin 2013, edhe në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë u shënuar progres, duke u përafëruar me standardet evropiane.

Në Raportin e KE-së për Kosovën të vitit 2020 theksohet se shtetit të Kosovës tani i mbetet të koncentrohet në zbatimin në praktikë të legjislacionit të fushës së sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës meqenëse konsiderohet se ato janë përafëruar mjaftueshëm me direktivat e BE-së<sup>65</sup>.

Kapaciteti i Inspektoratit të Punës ndër vite është konsideruar i mangët në Raportet e Vendit. Numri i vogël i inspektorëve, mungesa e të dhënave, mungesa e pajisjeve teknike, janë disa nga faktorët kyç që ndikojnë në mënyrë direkte në mos efikasitetin në punë të IP-së.

---

<sup>62</sup> Qeveria e Kosovës, (2021). Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) gjatë vitit 2020.

<sup>63</sup> Qeveria e Kosovës, (2020). Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) gjatë vitit 2019. Marrë nga: [https://www.mei-ks.net/repository/docs/raport\\_mbi\\_zbatimin\\_e\\_pkzmsa\\_gjate\\_vitit\\_2019.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/raport_mbi_zbatimin_e_pkzmsa_gjate_vitit_2019.pdf)

<sup>64</sup> European Commission (2020) Progress Report for Kosovo. Marrë nga [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>65</sup> European Commission (2020) Progress Report for Kosovo. Marrë nga: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)





Një fakt tjetër i rëndësishëm është se në Raportin e Vendit ndër të tjera shprehet edhe shqetësim sa i përket saktësisë së të dhënave të aksidenteve në vendin e punës<sup>66</sup>.

E rekomandim i ngjashëm është dhënë edhe në raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2021, i cili përcakton se implementimi i legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë mbetet i dobët, pasi që edhe pse kishte rritje të numrit të inspektimeve nga Inspektorati i Punës, këto inspektime kishin ndikim shumë të vogël, pasi që vëmendja ishte tek inspektimet e ndërlidhura me pandeminë COVID-19<sup>67</sup>.

## Rishikim i Planit Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021)

Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës, përcakton objektiva strategjike të cilat është synuar të arrihen në periudhën e caktuar kohore 2017-2021. Përmes këtyre objektiva në rradhë të parë synohej zhvillimi i Inspektoratit të Punës në mënyrë që të ndikohet në përmirësimin e të drejtave të punëtorëve sipas standardeve të BE-së dhe ILO-së<sup>68</sup>.

Kjo Strategji ka planin e veprimit vetëm për vitet 2017, 2018 ndërsa për vitet e tjera Inspektorati i Punës nuk hartoi Plan të Veprimit mirëpo deri në fund të vitin 2021 ky institucion punoi duke ndjekur objektivat e përgjithëshme të këtij plani strategjik zhvillimor.

Në përgjithësi, vërhet një planifikim jo shumë i mirë i objektivave. Kështu, në disa raste, një objektivë specifike përmban vetëm një aktivitet, e në disa raste aktiviteti është formuluar në mënyrë identike me objektivën specifike. Në planin e ri strategjik, IP duhet të ketë kujdes në planifikim e objektivave dhe aktiviteteve, në mënyrë që të ketë një planifikim sa më të mirë, për të përmirësuar punën e Inspektoratit të Punës.

Sidoqoftë, edhe pse në Planin Strategjik Zhvillimor është theksuar se monitorimi i zbatimit të këtij plani duhet të bëhet në mënyrë sistematike dhe rigoroze<sup>69</sup>, Inspektorati i Punës nuk ka përpiluar as edhe një raport mbi zbatimit e këtij plani strategjik zhvillimor për vite me rradhë.

Si i tillë Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021), përmbante gjithësej katër (4) objektiva strategjike dhe çdo objektivë ka edhe objektivat specifike.

---

<sup>66</sup> European Commission (2019) Progress Report for Kosovo. Marrë nga:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

<sup>67</sup> European Commission (2021) Progress Report for Kosovo. Marrë

nga: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)

<sup>68</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2020). Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>69</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>





## Objektiva Strategjike 1:

“Realizimi më i efektshëm i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i minimumit të standardeve duke zhvilluar procesin e inspektimit në fushat e marrëdhënieve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë”<sup>70</sup>.

Objektivat specifike:

1. “Ngritja e kualitetit të inspektimeve duke realizuar inspektime më përmbajtësore dhe më gjithëpërfshirëse, si dhe përmes rritjes së numrit të inspektimeve për 10% deri në fund të vitit 2017.

Objektivi specifik i lartpërmendur sa i përket pjesës së rritjes së numrit të inspektimeve është realizuar. Gjatë vitit 2017, Inspektorati i Punës ka kryer 10.4% më shumë inspektime në krahasim me vitin paraprak. Të dhënat statistikore tregojnë se edhe viteve pasuese kemi një rritje të numrit të inspektimeve. Megjithatë, rënia e numrit të inspektorëve për vite me rradhë vë në pikëpyetje kryerjen e inspektimeve më përmbajtësor.

2. Zvoglimi i punës së padeklaruar në punë për 5% dhe numrit të personave të angazhuar në punë në kundërshtim me ligjet në fuqi, për çdo vit duke filluar nga viti 2017”.

Inspektorati i Punës gjatë vitit 2017 arriti të legalizojë 1224 punëtorë<sup>71</sup>, ndërsa në vitin 2016 ishin gjithsej 1302<sup>72</sup> punëtorë të legalizuar që tregojnë një rënie në vitin 2017 pavarësisht objektivit të lartpërmendur.

Edhe më keq qëndron viti 2018 ku u legalizuan vetëm 712<sup>73</sup> punëtorë ndërsa viti 2019 shënon një rritje të numrit të punëtorëve të legalizuar me gjithësej 2042<sup>74</sup> për t'u përcjellë më pas me rënie në vitin 2020 me vetëm 409<sup>75</sup> punëtorë të legalizuar, numër ky shumë i ulët për arsye se jemi të vetëdijshëm se në tregun e punës në Kosovë është një numër i konsiderueshëm i punonjësve informal rreth 25.7%<sup>76</sup>.

## Objektiva Strategjike 2:

“Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve teknike të IP-së.”<sup>77</sup>

Objektivat specifike:

---

<sup>70</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>71</sup> Inspektorati i Punës, (2017). Raporti i Punës. Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Raporti-i-Punes-per-vitin-2017-nga-Inspektoriati-i-punes-2.pdf>

<sup>72</sup> Inspektorati i Punës, (2016) Raporti i Punës. Marrë nga: [https://ip.rks-gov.net/?page\\_id=2703](https://ip.rks-gov.net/?page_id=2703)

<sup>73</sup> Inspektorati i Punës, (2020). Raporti i Punës.

<sup>74</sup> Inspektorati i Punës, (2019). Raporti i Punës.

<sup>75</sup> Inspektorati i Punës, (2020). Raporti i Punës.

<sup>76</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, (2021). Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës.

<sup>77</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>



1. "Rritja e numrit të inspektorëve të punës për 10 persona në vitin 2017 dhe 2018.

Edhe pse inspektorati i punës ka ndarë buxhet për rekrutime të reja, në faqen zyrtare të Inspektoratit të Punës, duket se nga viti 2017 deri në vitin 2018 u hapen gjithsej katër (4) konkurse, nga të cilat vetëm një (1) konkurs i jashtëm dhe u rekrutuan vetëm tre (3) inspektorë të punës. Si rrjedhojë e kësaj, konkludojmë se ky objektivi nuk është realizuar.

Për më tepër, nga viti 2016 deri në vitin 2021 vetëm shtatë (7) inspektorë të punës janë rekrutuar duke përfshirë këtu edhe lëvizjet brenda kategorive.

2. Mbatja e 17 trajnimeve për inspektorët e punës lidhur me zbatueshmërinë e rregulloreve të veçanta nga siguria dhe shëndeti në punë të cilat dalin nga transponimi i direktivave individuale të KEE-së, deri në fund të vitit 2018 ose nga një trajnim për secilën direktivë të transponuar.

Inspektorati i Punës nuk posedon të dhëna të sakëta për numrin e tranimeve të realizuara ndër vite meqenëse mungon një sistem unifikues, mirëpo nga zyrtarët përgjegjës është pohuar se ky numër i trajnimeve është realizuar dhe me shumë mundësi është tejkaluar.

3. Organizimi dhe mbajtja e mbi 10 trajnimeve gjatë 2017 dhe 2018 për procedura administrative, menaxhim të financave publike dhe trajnime në sferën e mbrojtjes së të rinjve (15 – 18 vjet) të përcaktuara me legjislacionin pozitiv të Kosovës.
4. Krijimi i Sistemit Informativ të IP-së gjatë vitit 2017".<sup>78</sup>

Sistemi Informativ nuk është realizuar.

5. Pajisja me nga dy vetura për çdo vit"<sup>79</sup>.

Inspektorati i Punës, gjatë vitit 2017 ka marrë në pronësi katër (4) vetura të përdorura nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, në vitin 2019 ka blerë tri (3) vetura, gjatë vitit 2020 ka blerë vetëm një (1) vetur me buxhetin e Inspektoratit të Punës. Pra, gjatë zbatimit të Planit Strategjik Zhvillimor Inspektorati i Punës është pajisur me gjithsej tetë (8) vetura, prej tyre vetëm katër (4) vetura të blera me buxhetin e Inspektoratit të Punës.

Nga kjo konkludojmë se Inspektorati i Punës nuk ka realizuar as edhe këtë objektivi meqenëse nga viti 2017-2021 Inspektorati i Punës është dashur të pajiset me gjithsej dhjetë (10) vetura.

### Objektiva Strategjike 3:

"Përmirësimi i komunikimit të IP-së me të punësuarit dhe punëdhënësit dhe publikun në përgjithësi"<sup>80</sup>.

<sup>78</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>79</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2021). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>80</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2020). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>



Objektivat specifike:

1. "Mbajtja e 3-4 fushatave vetëdijësuese gjatë vitit 2017 dhe 2018 për rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së dispozitave të ligjeve dhe akteve nënligjore, ngritjen e vetëdijës për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të punëdhënësve dhe punëtorëve si nga fusha e marrëdhënies së punës ashtu edhe nga siguria dhe shëndeti në punë.
2. Krijimi i webfaqes funksionale të Inspektoratit të Punës gjatë vitit 2017.

Webfaqja e Inspektoratit të Punës është krijuar gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani. Mirëpo, nuk është plotësisht funksionale dhe si e tillë nuk ndikon në rritjen e transarencës së këtij organi. Kemi vetëm publikimin e raporteve të Inspektoratit të Punës edhe pse edhe këto publikime nuk janë të rregullta, mungon pjesa e publikimit të aktiviteteve që realizon Inspektorati i Punës si dhe tek pjesa e kontakteve shpesh mungon ripërrirja e të dhënave.

3. Krijimi i linjës komunikuese (call center) deri në fund të vitit 2017<sup>81</sup>.

Linja komunikuese e Inspektoratit të Punës është krijuar por nuk është funksionalizuar. Nga Inspektorati i Punës kemi marrë informatë se mungesa e burimeve njerëzore është faktori kryesor që rezultoi në mos përmbushjen e këtij objektiv.

#### Objektiva Strategjike 4:

"Avancimi i bashkërendimit ndër-institucional në zvoglimin e punësimit informal"<sup>82</sup>.

Objektivat specifike:

1. "Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me Policinë e Kosovës, Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve, Trustin Pensional, Inspektoratin e Bujqësisë deri në fund të vitit 2017.

Inspektorati i Punës për pesë vite me rradhë nuk ka arritur të nënshkruaj as edhe një memorandum bashkëpunimi me ndonjërin nga institucionet e lartëcekura.

2. Rritja për 10% e numrit të inspektimeve të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës deri në fund të vitit 2017<sup>83</sup>.

Të dhënat nga raportet e Inspektoratit të Punës pasqyrojnë një rritje të vogël të numrit të inspektimeve në bashkëpunim me institucionet e tjerë. Gjatë vitit 2017 janë kryer vetëm 79 inspektime në bashkëpunim IP me organet e tjera<sup>84</sup>, vite më tutje shihet një rritje relativisht e vogël e cila nuk premtion shumë në këtë drejtim. Gjatë vitit 2018 kemi 160 inspektime të IP-së me

<sup>81</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2020). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>82</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2020). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>83</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (2017). Plani Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës (2017-2020). <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Plani-zhvillimor-strategjik-i-IP-2017-2021.pdf>

<sup>84</sup> Inspektorati i Punës, (2017). Raporti i Punës. Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Raporti-i-Punes-per-vitin-2017-nga-Inspektoriati-i-punes-2.pdf>





institucionet e tjera<sup>85</sup>, ndërsa në vitin 2019 kemi rënie në 123<sup>86</sup>, pastaj në vitin 2020 janë kryer vetëm 66<sup>87</sup>, numër ky shumë i ulët në krahasim me qëllimin që ka objektivi i lartpërmendur.

Një numër i konsiderueshëm i sfidave në të cilat has inspektorati i punës reflektuan në mos realizimin e numrit të lartë të objektivave të lartpërmendura.

Siç është cekur më lartë, IP nuk ka nxjerrë asnjë raport në lidhje me implementimin e Planit Zhvillimor Strategjik. Për më tepër tani Inspektorati i Punës, ka formuar grupin punues për hartimin e Planit të ri Strategjik Zhvillimor për Inspektoratin e Punës, kjo pa bërë një raport mbi vlerësimin e Planit Strategjik Zhvillimor 2017-2021. IP duhet që fillimisht të dalë me një raport të detajuar rreth zbatimit të planit aktual, për të pasur më të qartë se çka do të përmbajë plani i ri strategjik.

## Analizë krahasimore

Në këtë pjesë të punimit analizohet korniza legislative dhe korniza institucionale e fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë, në vendet e tjera si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Letonia dhe Sllovenia.

### Shqipëria

#### Gjendja aktuale e sigurisë dhe shëndetit në punë

Shqipëria ka treguar progres në kornizën legislative të punësimit duke miratuar ligje të cilat kanë përfshirë transpozimin e direktivave në kuadër të BE-së për fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Problemi qëndron tek implementimit, gjatë vitit 2020 është parë një rritje e numrit të aksidenteve në vendin e punës me gjithsej 182<sup>88</sup> për dallim me vitin 2019 ku ishin 176 aksidente<sup>89</sup>, ndërsa në ato me fatalitet ka pasur rënie të numrit nga 38<sup>90</sup> që ishin në vitin 2019 në 36 në vitin 2020.<sup>91</sup>

---

<sup>85</sup> Inspektorati i Punës, (2018). Raporti i Punës. Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Raporti-12-Mujor-2018-.pdf>

<sup>86</sup> Inspektorati i Punës. (2019). Raporti i Punës.

<sup>87</sup> Inspektorati i Punës. (2020). Raporti i Punës. Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>

<sup>88</sup> ISHPSHSH(2020)Analizë Vjetore. Marrë nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Analize-vjetore-2020.pdf>

<sup>89</sup> ISHPSHSH(2019)ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT. Marrë nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-2019-ISHPSHSH.pdf>

<sup>90</sup> ISHPSHSH(2019)ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT. Marrë nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-2019-ISHPSHSH.pdf>

<sup>91</sup> ISHPSHSH(2020)Analizë Vjetore. Marrë nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Analize-vjetore-2020.pdf>



## Korniza Legjislative

Edhe Dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në mënyrë jo direkte përcaktojnë fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës ndërsa aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në mënyrë specifike e trajtojnë këtë fushë.

Neni 49 i Kushtetutës thekson se “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë”<sup>92</sup>.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë në kreun e VIII përcakton Sigurimin dhe Mbrojtjen e Shëndetit, ku në nene të veçanta specifikohet përgjegjësia e punëdhënësit ndaj punonjësve si dhe masat e përgjithëshme të cilat duhet të ndërmerren nga ana e punëdhënësit në vendin e punës me qëllim të evitimit të aksidenteve.<sup>93</sup>

Akti ligjor që në mënyrë specifike trajton fushën e sigurisë dhe shëndetit në Punë në Shqipëri është, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, miratuar me 18 shkurt 2010. Qëllim i këtij ligji është garantimi i sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit ku me anë të informimit dhe këshillimit të të punësuarve do të eliminohen dhe parandalohen rreziqet profesionale. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjithë sektorët e veprimtarisë private dhe publike.<sup>94</sup>

Në anën tjetër, Ligji Nr. 9634, Për Inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës, i cili hyri në fuqi në vitin 2006 përcakton se “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë, nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës, zbatimin e legjislacionit të Punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë”<sup>95</sup>.

## Korniza Institucionale

Qeveria e Shqipërisë nuk ka ministri që në mënyrë direkte merret me çështjen e punës. Organet përgjegjëse të cilat në mënyrë direkte merren me fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sherbimeve Shoqerore (ISHPSHSH) dhe Këshilli Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

---

<sup>92</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49. Marrë nga: <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al057sq.pdf>

<sup>93</sup> Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. 2003. Marrë nga:

<sup>94</sup> Ligji për Inspektimin e Punës (Shqipëri)

[http://www.ikub.al/LIGJE\\_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETeROR-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false](http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETeROR-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false)

<sup>95</sup> Ligji për Inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sherbimeve Shoqerore. Marrë nga: <https://www.infocip.org/al/?p=6025>





**ISHPSHSH**, u themelua në vitin 1993<sup>96</sup>, operon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si organ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjislacionit për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë për personat fizikë dhe juridikë, publik dhe privat.<sup>97</sup>

Më saktësisht, Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet e punës, kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, grave, gjithashtu është përgjegjës për dhënien e këshillave teknike për punëdhënësitë dhe punëmarrësit, të vë në dijeni autoritetet përgjegjëse për mangësitë si dhe për të propozuar mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes aktuale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.<sup>98</sup>

Udhëhiqet nga Inspektori i Përgjithshëm i cili emërohet nga kryeministri me jo më pak se pesë (5) vite përvojë pune<sup>99</sup>, ndërsa për punën e tij i raporton ministrit përkatës për Financa dhe Ekonomi.<sup>100</sup>

Duhet theksuar se Shqipëria ka koordinim në Inspektoratin e Punës, autoritetet qendrore kanë rol të qartë, më pas veprojnë dymbëdhjetë (12) Inspektorate Rajonale të Punës.<sup>101</sup>

Inspektorati përbëhet nga tri Drejtori: Drejtoria e Inspektimit, Drejtoria e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.<sup>102</sup> Është i mirëfilltë bashkëpunimi në mes drejtorive. Drejtoria për Inspektimi në bashkëpunim me Drejtorin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si drejtori përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, me qëllim të parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale në vendin e punës, koordinojnë punën. Bashkëpunimi krijohet përmes takimeve mujore në mes Inspektorit të Përgjithshëm dhe të gjithë drejtorëve rajonal.<sup>103</sup>

---

<sup>96</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Marrë nga:

<http://inspektoriatipunes.gov.al/sq/historiku-i-inspektoratit/>

<sup>97</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 2006. Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 për Insektimin. Marrë nga: [http://www.ikub.al/LIGJE\\_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false](http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false)

<sup>98</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 2006. Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 për Insektimin. Marrë nga: [http://www.ikub.al/LIGJE\\_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false](http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false)

<sup>99</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 2006. Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 për Insektimin. Marrë nga: <https://www.infocip.org/al/?p=6025>

<sup>100</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 2006. Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 për Insektimin. Marrë nga: [http://www.ikub.al/LIGJE\\_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false](http://www.ikub.al/LIGJE_CATEGORY2/13/08/21/PeRKRIJIMIN-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-INSPEKTORATIT-SHTETEror-Te-PUNeS-DHE0125.aspx?cookiesEnabled=false)

<sup>101</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS\\_112487/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_112487/lang--en/index.htm)

<sup>102</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS\\_112487/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_112487/lang--en/index.htm)

<sup>103</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS\\_112487/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_112487/lang--en/index.htm)





ISHPSHSH, përbëhet nga nëntëdhjetë (90) inspektorë<sup>104</sup> të cilët kanë statusin e nënpunësve civilë. Ky numër i inspektorëve vlerësohet si i pa mjaftueshëm për t'u arritur qëllimi i këtij organi, andaj edhe me raportin e Progresit të viti 2020, kërkohet të forcohet kapaciteti i burimeve njerëzore në këtë organ<sup>105</sup>.

ISHPSHSH, gjatë vitit 2020 me kapacitetin e burimeve njerëzore që ka operuar ka arritur të realizoj 5993 inspektime, pra një inspektor gjatë vitit ka realizuar 67 inspektime.

**Këshilli Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, është organ tjetër i rëndësishëm për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, detyrat kyçe të të cilit janë:

a) "të këshillojë Këshillin e Ministrave për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Për çështje të një rëndësie të veçantë, këshilli kombëtar ndërministror për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me Këshillin Kombëtar të Punës;

b) të propozojë në Këshillin e Ministrave programet kryesore për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë;

c) të vlerësojë gjendjen konkrete të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe të paraqet propozime e rekomandime për përmirësimin e gjendjes, për ministrinë përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe autoritetet e tjera shtetërore përgjegjëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) të miratojë raportin vjetor për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, të paraqitur nga ministri përgjegjës për këto çështje".<sup>106</sup>

Shqipëria	
Korniza Legjislative	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kushtetuta;</li><li>- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;</li><li>- Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;</li><li>- Ligji për Inspektimin e Punës;</li></ul>

<sup>104</sup> Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, (2019). Analizë Statistike e Treguesve të Inspektimit. Marrë nga: <http://inspektoriatipunes.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-2019-ISHPSHSH.pdf>

<sup>105</sup> European Commission (2020) Progress Report for Albania. Marrë nga: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf)

<sup>106</sup> Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2010) Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë: <https://www.dpshttr.al/sites/default/files/downloads/dokumente/Ligji%20Nr.10237%2C%20dat%20AB%2018.02.2010%20E2%80%9CP%20C3%ABr%20Sigurin%20dhe%20Sh%20C3%ABndetin%20n%20C3%AB%20Pun%20C3%AB%20E2%80%9C.pdf>



Korniza Institucionale	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;</li><li>- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;</li><li>- Këshilli Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë;</li></ul>

## Kroacia

### Gjendja aktuale

Ekziston një bashkëpunim i mirëfilltë i institucioneve të cilat janë përgjegjës për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë me qëllim të hartimit të politikave, strategjive dhe akteve normative kombëtare.<sup>107</sup> Gjatë vitit 2019 në Kroaci ishin 982 aksidente në vendin e punës, prej tyre 53 pësuan me fatalitet.<sup>108</sup>

### Korniza Legjislative

Korniza legjislative në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Kroaci rregullohet me Ligjin e Punës dhe Ligjin mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës. Ligji aktual i punës është miratuar nga Parlamenti i Kroacisë në vitin 2004.<sup>109</sup> Në kapitullin e tretë është e paraparë Mbrotja e jetës, shëndetësisë, privatësisë dhe dinjiteti të punëtorëve. Në nenin 28 përcaktohet se punëdhënësi duhet të sigurojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve, duke u bazuar në përputhje me natyrën e punës në mënyrë që të parandalohen aksidentet e mundshme.<sup>110</sup>

Duhet theksuar se fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë për herë të parë u rregullua në vitin 1996 me Ligjin e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Vendin e Punës (OG 59/96). Që nga ajo periudhë ligji ka pësuar rreth 50 ndryshime.<sup>111</sup> Ndryshimi i fundit i këtij aktit ligjor ishte në vitin 2014 me miratimin e Ligjit mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Vendin e Punës nga parlamenti i Kroacisë.<sup>112</sup>

<sup>107</sup> <https://osha.europa.eu/hr/about-eu-osha/national-focal-points/hrvatska>

<sup>108</sup> <https://www.total-croatia-news.com/business/50632-workplace-fatalities-in-construction-sector-up-75-in-past-3-years>

<sup>109</sup> Komisioni Legjislativ i Parlamentit Kroat, Akti i Punës, (2004). Marrë nga:

[http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation\\_\\_Labour-Act.pdf](http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation__Labour-Act.pdf)

<sup>110</sup> Komisioni Legjislativ i Parlamentit Kroat, Akti i Punës, (2004). Marrë nga:

[http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation\\_\\_Labour-Act.pdf](http://www.vsrh.hr/CustomPages/Static/HRV/Files/Legislation__Labour-Act.pdf)

<sup>111</sup> Ligji i ri për Siguri dhe Shëndet në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>112</sup> The Croatian Parliament Occupational Health and Safety, Marrë nga:

<https://mrosp.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Uprava%20za%20rad/ohs-act.pdf>





Disa nga ndryshimet të cilat janë të përfshira në Ligjin e vitit 2014 mbi shëndetin dhe sigurinë kanë të bëjnë me përdorimin e teknologjisë së re, dhe për herë të parë me këtë ligj adresohet drejtpërdrejt çështja e lidhura me stresin që përjetojnë të punësuarit në vendin e punës ose lidhur me punën.<sup>113</sup>

Objektivi i kryesor i këtij ligji është që ti mbrojë të punësuarit në mjedisin e punës dhe të parandalojë dëmtimet dhe sëmundjet e ndryshme.<sup>114</sup> Gjithashtu, qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, të sigurojë zhvillimin e papenguar mendor dhe fizik të të rinjve, të mbrojë gratë, të mbrojë personat me aftësi të kufizuara dhe personat me sëmundje profesionale.<sup>115</sup>

Rregullat për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në vendin e punës kanë për qëllim eliminimin e rreziqeve në punë, parandalimin e dëmtimeve në punë, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet e tjera.<sup>116</sup>

## Korniza Institucionale

Mekanizmat përgjegjëse për mbikëqyrjen e fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë janë: Ministria e Punës dhe Sistemit Pensional, Familjes dhe Politikës Sociale, Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Punë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Instituti për Avancimin e Sigurisë në Punë.

**Ministria e Punës, Sistemit Pensional, Familjes dhe Politikës Sociale:** ka funksione administrative dhe detyra të tjera që lidhen me: ligjin e punës, tregun e punës, punësimin dhe politikën e tregut të punës, regjistrat lidhur me papunësinë, rikualifikimin e punës dhe programet e rritjes së punësimit.<sup>117</sup>

---

<sup>113</sup> Ligji i ri për Siguri dhe Shëndet në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>114</sup> Ligji i ri për Siguri dhe Shëndet në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>115</sup> Ligji i ri për Siguri dhe Shëndet në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>116</sup> Ligji i ri për Siguri dhe Shëndet në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>117</sup> Ministria e Punës, Sistemit Pensional, Politikës Familjare dhe Sociale. Marrë nga:

<https://mrosp.gov.hr/about/7147>





**Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Punë:** Është krijuar në Tetor të vitit 2000 nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.<sup>118</sup> Është organ këshillues, me qëllim kryesor të monitorimit të vazhdueshëm të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë, rishikimit dhe propozimit e ndryshimeve legjislative me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, duke bashkëpunuar me përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëtorëve.<sup>119</sup>

Detyrë kryesore ka: analizimin, vlerësimin e politikave që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, si dhe ofron propozime tek Qeveria për ndryshimet eventuale.<sup>120</sup>

Detyrë tjetër e këshillit është edhe monitorimi i zbatimit të ligjit, rregulloreve dhe ligjeve specifike që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, propozon masa konkrete për përmirësimin e sistemit të shëndetit dhe sigurisë në punë.<sup>121</sup>

Këshilli Kombëtar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen me vendim të Qeverisë, dy përfaqësues të propozuar nga ministri përgjegjës për punën, një përfaqësues i propozuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, dy përfaqësues të punëdhënësve, dy përfaqësues të punëtorëve të propozuar nga shoqatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve të niveleve më të larta sipas një rregulloreje të veçantë.<sup>122</sup>

Gjithashtu, Këshilli nëse është e nevojshme mund t'i propozojë Qeverisë ndryshime me qëllim të përafrimit të tyre me rregulloret ndërkombëtare, si dhe propozon masa për përmirësimin e sistemit të sigurisë në vendin e punës në Republikën e Kroacisë.

**Inspektoriati Shtetëror i Punës:** funksionon si organizatë administrative dhe buxhetore në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Sistemit Pensional, e cila njëkohësisht është edhe përgjegjëse për financim të tij.<sup>123</sup> Inspektoriati shtetëror i punës funksionon duke u bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës i miratuar në vitin 2014, ku janë përcaktuar funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi. Funksioni kryesor i Inspektoratit të Punës është kryerja e inspektimeve në fushën e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, përveç në rastet kur me ligj është parashikuar ndryshe.

---

<sup>118</sup> Occupational Safety and Health (OSH), Croacia 2016, Marrë nga:

[https://www.ilo.org/dyn/legosh/en/f?p=14100:1100:0::NO:1100:P1100\\_ISO\\_CODE3,P1100\\_SUBCODE\\_CODE,P1100\\_YEAR:HRV,,2016:NO](https://www.ilo.org/dyn/legosh/en/f?p=14100:1100:0::NO:1100:P1100_ISO_CODE3,P1100_SUBCODE_CODE,P1100_YEAR:HRV,,2016:NO)

<sup>119</sup> Croatia: New Law in occupational health and safety, Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>120</sup> Croatia: New Law in occupational health and safety, Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>121</sup> Croatia: New Law in occupational health and safety, Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>122</sup> Occupational Safety and Health (OSH), Croacia 2016, Marrë nga:

[https://www.ilo.org/dyn/legosh/en/f?p=14100:1100:0::NO::P1100\\_ISO\\_CODE3,P1100\\_SUBCODE\\_CODE,P1100\\_YEAR:HRV,,2016](https://www.ilo.org/dyn/legosh/en/f?p=14100:1100:0::NO::P1100_ISO_CODE3,P1100_SUBCODE_CODE,P1100_YEAR:HRV,,2016)

<sup>123</sup> The Croatian Parliament, Labour Inspectorate Act, Marrë nga:

<http://www.mvep.hr/files/file/dokumenti/prevodenje/zakoni/zakon-o-inspektoratu-rada-nn-19-14-eng.pdf>



<sup>124</sup>Inspektorati është i organizuar në zyrë qendrore, zyrat regjionale dhe degët e zyrave regjionale.<sup>125</sup>

Inspektorët nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës përfshijnë: inspektimin në lidhje me lëndimet në vendin e punës, mbikëqyrjen e punës së personave të autorizuar për të bërë vlerësimin e sigurisë në vendin e punës, si dhe inspektimin se sa po respektohet rregullorja e veçantë e ndërtimit lidhur me sigurinë në zonën e ndërtimit.<sup>126</sup>

Inspektorët e punës janë të autorizuar të marrin vendime për ndërprerjen e çdo aktiviteti i cili konsiderohet se rrezikon shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.<sup>127</sup>

**Instituti për Avancimin e Sigurisë në Punë** - është institucion publik, i themeluar nga Qeveria e Kroacisë në vitin 2014.<sup>128</sup> Instituti për Avancimin e Sigurisë në Punë mori të gjitha funksionet e Institutit Kroat për Mbrojtjen e Sigurisë dhe Shëndetit në vendin e Punës. Funksionet e Institutit janë të përshkruara në Aktin e Shëndetit dhe Sigurisë në Vendin e Punës. Objektivi kryesor i Institutit përqendrohet në aspektet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Instituti do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe propozimin e masave për të përmirësuar sigurinë në vendin e punës. Instituti gjithashtu, merret edhe me monitorimin e trajnimit dhe çertifikimit të punëtorëve dhe organizatave.<sup>129</sup>

Funksionet kryesore të Institutit janë: monitorimi i fushës së shëndetit dhe sigurisë në punë, të përgatisë udhëzime dhe metoda që mund të ndikojnë në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, të realizoj sondazhe statistikore, bashkëpunimi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe institucione profesionale dhe shkencore.<sup>130</sup> Instituti siguron ndihmë profesionale për sindikatat e punëdhënësve, personat e autorizuar për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe detyra të tjera të përcaktuara me dispozita ligjore.

## Kroacia

<sup>124</sup> The Croatian Parliament, Labour Inspectorate Act, Marrë nga:

<http://www.mvep.hr/files/file/dokumenti/prevodenje/zakoni/zakon-o-inspektoratu-rada-nn-19-14-eng.pdf>

<sup>125</sup>The Croatian Parliament, Labour Inspectorate Act, Marrë nga:

<http://www.mvep.hr/files/file/dokumenti/prevodenje/zakoni/zakon-o-inspektoratu-rada-nn-19-14-eng.pdf>

<sup>126</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar-Kroaci. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_National\\_Level\\_-\\_Croatia#Other\\_OSH\\_bodies](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_National_Level_-_Croatia#Other_OSH_bodies)

<sup>127</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar-Kroaci. Marrë nga

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_National\\_Level\\_-\\_Croatia#Other\\_OSH\\_bodies](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_National_Level_-_Croatia#Other_OSH_bodies)

<sup>128</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar-Kroaci. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_National\\_Level\\_-\\_Croatia](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_National_Level_-_Croatia)

<sup>129</sup> Ligji i ri për Sigurinë dhe Shëndetit në Vendin e Punës. Marrë nga:

<https://www.eurofound.europa.eu/publications/article/2015/croatia-new-law-on-occupational-health-and-safety>

<sup>130</sup>Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar-Kroaci. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_National\\_Level\\_-\\_Croatia#Other\\_OSH\\_bodies](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_National_Level_-_Croatia#Other_OSH_bodies)



<b>Korniza Legjislative</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i Punës;</li> <li>- Ligjin mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës;</li> </ul>
<b>Korniza Institucionale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Punës, Sistemit Pensional, Familjes dhe Politikës Sociale;</li> <li>- Inspektoriati shtetëror i punës;</li> <li>- Instituti për Avancimin e Sigurisë në Punë;</li> <li>- Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Punë;</li> </ul>

## Slovenia

### Gjendja aktuale

Vlerësohet si i nevojshëm ndryshimi i legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë me qëllim të përmirësimit të situatës aktuale, ku vetëm në vitin 2019 kanë ndodhur 191 aksidente në vendin e punës<sup>131</sup>. Kapaciteti i burimeve njerëzore në inspektoratin e punës si organ për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk është i kënaqshëm edhe pse vetëm gjatë vitit 2019 janë punësuar 121 punonjës<sup>132</sup>.

### Korniza legjislative

Korniza Legjislative në Slloveni rregullohet nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe Ligji për Shëndet dhe Sigurinë në Vendin e Punës.

Ligji për Marrëdhëniet e Punës, si fillim është miratuar në vitin 2002. Në vitin 2013 është bërë modifikimi i fundit i ligjit. Neni 33 i Ligjit për marrëdhëniet e punës të Sllovenisë parasheh dispozitat për sigurinë dhe shëndetin në punë. Punëdhënësi duke i respektuar dispozitat për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës është i obliguar të siguroj një ambient të sigurt për të punësuarit.<sup>133</sup>

<sup>131</sup> Republika Slovenija Ministrstvo Za Delo, [ [Ê Á Ö ; ~ : ã } \[ Ê Á Ù \[ & ã æ | } ^ Á Z æ á ^ ç ^ Á ã } Á Ò } æ \](https://www.gov.si/assets/organi-v-sestavi/IRSD/LETNA-POROCILA-IRSD/Porocilo-o-delu-IRSD-v-letu-2019.pdf) Republike Slovenije Za Delo, Marrë nga: <https://www.gov.si/assets/organi-v-sestavi/IRSD/LETNA-POROCILA-IRSD/Porocilo-o-delu-IRSD-v-letu-2019.pdf>

<sup>132</sup> Republika Slovenija Ministrstvo Za Delo, Druzino, Socialne Zadeve in Enake Možnosti Inšpektorat Republike Slovenije Za Delo, Marrë nga: <https://www.gov.si/assets/organi-v-sestavi/IRSD/LETNA-POROCILA-IRSD/Porocilo-o-delu-IRSD-v-letu-2019.pdf>

<sup>133</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p\\_lang=en&p\\_isn=97493&p\\_country=SVN&p\\_count=561](https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=en&p_isn=97493&p_country=SVN&p_count=561)



Ligji për shëndet dhe siguri në vendin e punës në Slloveni është miratuar në vitin 2011.<sup>134</sup> Qëllimi kryesor i këtij akti ligjor është që të përcaktohen detyrat kryesore të punëdhënësve dhe të punëmarrësve lidhur me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës si dhe përcaktimin e masave të nevojshme për garantimin e sigurisë së të punësuarve<sup>135</sup>.

Në vitin 2011 Asambleja Kombëtare e Republikës së Sllovenisë, ka miratuar një program kombëtar me anë të së cilës përcaktohen strategjitë për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Me anë të këtij programi Asambleja Kombëtare ka për fokus të mbrojtje jetën e punëtorëve, shëndetin dhe të parandalojë aksidentet dhe sëmundjet profesionale në vendin e punës.<sup>136</sup>

### Korniza Institucionale

Në Slloveni përgjegjëse për fushën e punës janë: Këshilli për Punë dhe Siguri në Vendin e Punës Ministria e Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale, Inspektorati i Punës, Inspektimi i Energjisë dhe Minierave.<sup>137</sup>

**Këshilli për Punë dhe Siguri në Vendin e Punës:** funksionon si organ këshillimor. Këshilli propozon dhe diskuton rekomandimet tek Ministria përkatëse lidhur me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, si dhe përcaktimin e politikave të njëtrajtshme. Trupi i Këshillit përfshinë ekspertë të njohur në fushat e tyre përkatëse.<sup>138</sup>

Përbëhet nga ekspertë të sigurisë e shëndetit në punë, sigurime shoqërore dhe ekspertë nga organizatat apo sindikatat e punëdhënësve. Anëtarët e këshillit nga organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat emërohen nga Ministri me propozimin e Këshillit Ekonomik dhe Social.<sup>139</sup>

**Ministria e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta-** ka këto funksione: statusin, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve, skemat e sigurimit pensional dhe ato për personat me aftësi të kufizuara; marrëveshjet kolektive; politikat e punësimit brenda dhe jashtë vendit; parandalimin e punësimit të padeklaruar; statusin dhe mbrojtjen e plotë sociale të personave me aftësi të kufizuara; të rinjve, fëmijëve dhe familjeve; bursat dhe aftësimin

---

<sup>134</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Punës. Marrë nga:

<http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO5537>

<sup>135</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Punës. Marrë nga:

<http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO5537>

<sup>136</sup> OSH System at national level - Slovenia, marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Slovenia#OSH\\_authorities\\_and\\_inspection\\_services](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_national_level_-_Slovenia#OSH_authorities_and_inspection_services)

<sup>137</sup> Republic of Slovenia Government, About the Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities, Marrë nga:

<https://www.gov.si/en/state-authorities/ministries/ministry-of-labour-family-social-affairs-and-equal-opportunities/about-the-ministry-of-labour-family-social-affairs-and-equal-opportunities/>

<sup>138</sup> OSH System at national level- Slovenia, marrë

nga: [https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Slovenia#OSH\\_authorities\\_and\\_inspection\\_services](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_national_level_-_Slovenia#OSH_authorities_and_inspection_services)

<sup>139</sup> OSH System at national level- Slovenia, marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_system\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Slovenia#OSH\\_authorities\\_and\\_inspection\\_services](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_system_at_national_level_-_Slovenia#OSH_authorities_and_inspection_services)





profesional; sigurinë në punë; familjen dhe politikën demografike; mbrojtjen dhe mirëqenien sociale; ndihmën sociale për individët e privuar; familjet dhe grupet e popullsisë; situatën e grave dhe sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat; trajnimin e fëmijëve me çrregullime të zhvillimit, etj.<sup>140</sup>

**Inspektorati i Punës-** është organ administrativ në kuadër të Ministrisë së Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale. Inspektorati i Punës është organ mbikëqyrës i zbatimit të ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe i njëjti funksionon në kuadër të rregulloreve të nxjerra në bazë të tij, si dhe rregulloret e tjera që rregullojnë fushën e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Inspektorati i punës merret gjithashtu edhe me mbikëqyrjen e masave të sigurisë të specifikuar në aktet e përgjithshme të punëdhënësit. Inspektorati i Punës gjithashtu u siguron punëdhënësve dhe punëtorëve ndihmë në lidhje me zbatimin dhe rregulloret e tjera, kontratat kolektive dhe aktet e përgjithshme brenda juridiksionit të tij.

**Inspektimi i Energjisë dhe Minerave:** siguron mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve nga fusha e inxhinierisë elektrike dhe të minierave.

“Përmes inspektimeve në fushën e energjisë elektrike, sigurohet zbatimi i rregulloreve për funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të pajisjeve të energjisë, d.m.th. pajisjet gjeneruese të energjisë elektrike, rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pajisjet e tjera për furnizimin dhe përdorimin e energjisë elektrike.”<sup>141</sup> Me sigurimin e kontrolleve, inspektorët ndihmojnë në korigjimin e mangësive gjatë ndërtimit ose fazës së rindërtimit të makinave të energjisë, gjë që përmirëson sigurinë, besueshmërinë dhe përdorimin ekonomik të makinave të tilla. Kontrollat e sistemeve të tensionit të ulët në ndërtesa dhe sistemet e mbrojtjes nga rrufeja në ndërtesat publike kanë për qëllim sigurimin e sigurisë duke zvogëluar rreziqet për të punësuarit, kafshët dhe pronën<sup>142</sup>

Inspektoriati i minierave ka për qëllim kryesor sigurinë dhe shëndetin në punimet nëntokësore dhe të minierave sipërfaqësore. Inspektorët kryejnë inspektime në bazë të akteve legjislative që rregullojnë minierat, sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në vendin e punës. Qëllimi i inspektoriatit të minierave është inspektimi në baza të rregullta në fushën e minierave. Në rastet

---

<sup>140</sup> Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities - Slovenia, Marrë nga: <https://oiraproject.eu/it/Partners/ministry-labour-family-social-affairs-and-equal-opportunities#:~:text=Ministry%20of%20Labour%2C%20Family%2C%20Social%20Affairs%20and%20Equal,of%20Labour%2C%20Family%2C%20Social%20Affairs%20and%20Equal%20Opportunities>

<sup>141</sup> Republic of Slovenia Government, About the Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities, Marrë nga:

<https://www.gov.si/en/state-authorities/ministries/ministry-of-labour-family-social-affairs-and-equal-opportunities/about-the-ministry-of-labour-family-social-affairs-and-equal-opportunities/>

<sup>142</sup> Republic of Slovenia Government, Energy and Mining Inspection, Marrë nga:

<https://www.gov.si/en/state-authorities/bodies-within-ministries/inspectorate-of-infrastructure/o-inspektoratu-za-infrastrukturo/inspekcija-za-energetiko-in-rudarstvo/>







e aksidenteve fatale ose aksidenteve në grup në vendin e punës ose incidenteve të rrezikshme, inspektorati i fushës hap një hetim për të shqyrtuar rrethanat.<sup>143</sup>

Sllovenia	
Korniza Legjislative	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i Punës</li> <li>- Ligji për Shëndet dhe Siguri në Vendin e Punës</li> </ul>
Korniza Institucionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Punës, Familjes, Cështjeve, Sociale dhe Mundësive të Barabarta</li> <li>- Inspektorati i Punës,</li> <li>- Inspektimi i Energjisë dhe Minierave</li> </ul>

## MAQEDONIA E VERIUT

### Gjendja aktuale e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Shkalla e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në Maqedoninë e Veriut vlerësohet në nivel jo të duhur. Mungon zbatimi i legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë, mungon bashkëpunimi ndërinstytucional, vlerësohet i mangët kapaciteti administrativ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, edhe pse gjatë vitit 2019 kishte progres në rekrutimin e inspektorëve të ri<sup>144</sup>, progres pati edhe në vitin 2020 ku u rekrutuan pesë (5) inspektorë të rinj<sup>145</sup>.

Gjatë vitit 2020 u raportuan 667 lëndime në vendin e punës, ku 18 prej tyre pësuan me fatalitet.<sup>146</sup>

<sup>143</sup> Zakon o varnosti in zdravju pri delu (ZVZD-1), Marrë nga:

<http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO5537>

<sup>144</sup> Komisioni Evropian, (2020). Raporti i Progresit për Maqedoninë e Veriut. Marrë nga:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north\\_macedonia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf)

<sup>145</sup> Komisioni Evropian, (2021). Raporti i Progresit për Maqedoninë e Veriut. Marrë nga:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en)

<sup>146</sup> Inspektorati i Shtetëror i Punës në Maqedoninë e Veriut, (2020). Raporti i Punës. Marrë nga:

[https://dit.gov.mk/~drzaveninspekt/?page\\_id=6878#](https://dit.gov.mk/~drzaveninspekt/?page_id=6878#)





## Korniza Legjislative

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 32 parasheh fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, ku thuhet “Çdokush ka të drejtë për të punuar, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe siguri materiale gjatë papunësisë së përkohshme”.<sup>147</sup>

Siguria dhe Shëndeti në vendin e Punës në Maqedonin e Veriut përcaktohet edhe me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, në nenin 32 thuhet se “Punëmarrësi është i detyruar t'i respektojë dhe zbatojë dispozitat për mbrojtje në punojnë, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e tyre, si dhe shëndetin dhe jetën e të tjerëve persona. Është e drejtë dhe detyrim i çdo punëtori që të kujdeset për sigurinë e tij dhe sigurinë e personave të tjerë që punojnë me të, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi, për t'u njohur masat e sigurisë së shëndetit në punë dhe të trajnohen në zbatimin e tyre, në përputhje me rregulloret për sigurinë dhe shëndetin në punë”<sup>148</sup>.

Ndërsa, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në mënyrë specifike rregullon fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, ku përcakton masat parandaluese, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit si dhe strukturën organizative të sistemit të kujdesit shëndetësor.

## Korniza Institucionale

Në Maqedonin e Veriut Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është autoriteti kryesor për çështjet e punës dhe mbrojtjes sociale.

Fusha e Sigurisë dhe Shëndetit, është brenda kompetencës së Inspektoratit Shtetëror të punës, i cili është organ i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

**Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP)**- qëllim kryesor ka mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të tjera për marrëdhëniet e punës, punësimin dhe mbrojtjen në punë si dhe marrëveshjesë kolektive<sup>149</sup>.

Puna dhe organizimi në këtë institucion rregullohet me Ligjin mbi Inspektimin në Punë. ISHP, funksion si organ brenda Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale<sup>150</sup>.

---

<sup>147</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Marrë nga:  
<https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>

<sup>148</sup> Ligji për Marrëdhëniet e Punës, (2005). Marrë nga:  
[https://mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9E%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8.pdf](https://mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9E%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8.pdf)

<sup>149</sup> Ligji për Inspektimin e Punës. Marrë nga:  
[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

<sup>150</sup> Ligji për Inspektimin e Punës. Marrë nga:  
[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)





Autoriteti më i lartë është Drejtori i Inspektoratit me të paktën pesë (5) vite përvojë pune profesionale, emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e vendit për një mandat katër (4) vjeçar me mundësin edhe të një mandati tjetër<sup>151</sup>.

Në anën tjetër, inspektori në ISHP duhet të ketë një diplomë universitare në fushën e Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturës, Inxhinierisë Elektrike, ose dhe diplomë universitare në fushën e Teknologjisë dhe Sigurisë në Punë<sup>152</sup>. Gjithashtu, inspektori duhet të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit si dhe të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit duke u bazuar në rregulloren në lidhje me nënpunësit civilë<sup>153</sup>.

**Këshilli për Siguri dhe Shëndet gjatë punës**- është i përbërë nga një grup ekspertësh këshillëdhënës që formohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Këshilli shqyrton dhe jep mendime dhe udhëzime lidhur me programin në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës, strategjinë për parandalimin dhe zvogëlimin e lëndimeve në vendin e punës, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet dhe lëndimet tjera të cilat janë të lidhura me punë, poashtu shqyrton bazat e ekspertëve për hartimin e ligjeve dhe dispozitave tjera mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe dokumentet e organizatave ndërkombëtare në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.<sup>154</sup>

Këshillin e përbëjnë pesëmbëdhjetë (15) anëtarë: katër (4) anëtarë nga organizatat reprezentative të punëdhënësve, katër (4) anëtarë nga sindikatat reprezentative, tre (3) anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, një (1) anëtar përfaqësues i fakultetit i cili zbaton veprimtari arsimore në fushën e mjekësisë së punës, një (1) anëtar përfaqësues i shoqatës së personave profesionale për siguri gjatë punës dhe një (1) anëtar përfaqësues i shoqatës së eksperteve të mjekësisë së punës.<sup>155</sup>

---

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

<sup>151</sup> Ligji për Inspektimin e Punës. Marrë nga:

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

<sup>152</sup> Ligji për Inspektimin e Punës. Marrë nga;

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

<sup>153</sup> Ligji për Inspektimin e Punës. Marrë nga:

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

[https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud\\_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%98%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D0%A2%D1%80%D1%83%D0%B4.pdf)

<sup>154</sup> BalconOSH. Siguria dhe Shëndeti në Vendin e Punës, (2018). Marrë nga: <http://project-balconosh.net/wp-content/uploads/2018/11/OCCUPATIONAL-SAFETY-AND-HEALTH-STUDY-MACEDONIA.pdf>

<sup>155</sup> BalconOSH. Siguria dhe Shëndeti në Vendin e Punës, (2018). Marrë nga: <http://project-balconosh.net/wp-content/uploads/2018/11/OCCUPATIONAL-SAFETY-AND-HEALTH-STUDY-MACEDONIA.pdf>





Maqedonia e Veriut	
Korniza Legjislative	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kushtetuta</li><li>- Ligjin për Marrëdhëniet e Punës</li><li>- Ligji për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës</li><li>- Ligji për Inspektimin e Punës</li></ul>
Korniza Institucionale	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</li><li>- Inspektorati Shtetëror i Punës</li><li>- Këshilli për Siguri dhe Shëndet gjatë punës</li></ul>

## Serbia

### Gjendja aktuale në Serbi

Shkalla e sigurisë dhe e shëndetit në punë në Serbi është e ulët, ka mungesë në zbatim të ligjit në fuqi<sup>156</sup>, vetëm gjatë vitit 2020 ishin 10,295 lëndime në vendin e punës, prej tyre 11 pësuan me fatalitet<sup>157</sup>.

Legjislacioni i punës është përafër me acquis të EU-së. Ligji për mbikëqyrjen e inspektimit shihet i nevojshme të ndryshohet me qëllim të harmonizimit me Konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës që u ratifikuan më parë nga shteti i Serbisë.<sup>158</sup>

### Korniza Legjislative

Siguria dhe Shëndeti në Punë përcaktohet me dispozita kushtetuese në mënyrë direkte, theksohet se duhet të respektohet dinjiteti i personave në punë në mënyrë që të krijohen kushtet e sigurt dhe të shëndetshme, të respektohet orari i punës, pushimet ditore, javore, vjetor, si dhe

<sup>156</sup>Komisioni Evropian, (2019). Raporti i Progresit për Serbin. Marrë nga:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/serbia_report_2020.pdf)

<sup>157</sup> Qeveria e Serbisë, (2021). Ministria e Punës, Punësimit, Çështjeve të Veteranëve dhe Çështjeve

Sociale. Marrë nga: <https://www.minrzs.gov.rs/sites/default/files/2021-03/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BF%20%D1%80%D0%B0%D0%B4%D1%83%20%D0%A3%D0%BF%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B5%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B1%D0%B7%D1%80%20%D0%B7%D0%B0%202020.%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D1%83.pdf>

<sup>158</sup> Komisioni Evropian, (2020). Raporti i Progresit për Serbin. Marrë nga:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/serbia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/serbia_report_2020.pdf)





kompenzimi i drejtë për punë etj.<sup>159</sup> Ligji i të Drejtës në Punë, në kapitullin VII parasheh mbrojtjen e punonjësve në vendin e punës, duke përfshirë këtu mbrojtjen e jetës dhe shëndetit në punë.<sup>160</sup> Në anën tjetër ligji i veçantë që rregullon fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë është Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Qëllim thelbësor ka "zbatimin dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të personave që marrin pjesë në procesin e punës, si dhe personave që gjenden në mjedisin e punës, me qëllim parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve që lidhen me punën".<sup>161</sup>

**Shoqata Serbe për Shëndet dhe Siguri në Punë** - është formuar si një asocacion profesional që i mbledh ekspertët, inxhinieret, përfaqësuesit e punonjësve dhe personat e tjerë të cilë janë profesionalisht të orientuar për sistemin e sigurisë dhe shëndetin në punë. Qëllimi i kësaj është shoqate është i bazuar në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe përmirësimin e ambientit dhe kushteve të punës. Shoqata është regjistruar me 21 dhjetor 2004 si një organizatë vullnetare, profesionale, apolitike, joqeveritare dhe jo fitimprerëse. Shoqata tani ka më shumë se 500 anëtarë, përbëhet nga presidenti i cili e menaxhon bordin.<sup>162</sup>

**Ministrisë së Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale të Republikës së Serbisë**- brenda kësaj ministrie funksionon Drejtoria për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si organ administrativ<sup>163</sup>. Detyrat kyçe janë: kujdesi për harmonizimin e rregulloreve me rregulloret e BE-së dhe ILO-së, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi dëmtimin në punë, si dhe për këtë del me raporte vjetore, ofronë edukim për zyrtarët përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe për inspektorët, informon publikun për gjendjen në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë<sup>164</sup>.

**Inspektorati i Punës**, vepron brenda Ministrisë së Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale, ka rol kyç në mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që i përkasin fushës së punës, fushës së marrëdhënieve të punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë.<sup>165</sup>

---

<sup>159</sup> Kushtetuta e Serbisë. Marrë nga: [https://www.srbija.gov.rs/view\\_file.php?file\\_id=2391&cache=sr](https://www.srbija.gov.rs/view_file.php?file_id=2391&cache=sr)

<sup>160</sup> Ligji i të Drejtës në Punë. Marrë nga: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_radu.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_radu.html)

<sup>161</sup> Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_bezbednosti\\_i\\_zdravlju\\_na\\_radu.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_bezbednosti_i_zdravlju_na_radu.html)

<sup>162</sup> Siguria dhe Shëndeti në Vendin e Punës. Marrë nga: [http://web.deu.edu.tr/isamer/OHS\\_Serbia.pdf](http://web.deu.edu.tr/isamer/OHS_Serbia.pdf)

<sup>163</sup> Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_bezbednosti\\_i\\_zdravlju\\_na\\_radu.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_bezbednosti_i_zdravlju_na_radu.html)

<sup>164</sup> Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_bezbednosti\\_i\\_zdravlju\\_na\\_radu.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_bezbednosti_i_zdravlju_na_radu.html)

<sup>165</sup> Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale. Marrë nga:  
<https://www.devex.com/organizations/ministry-of-labor-employment-veteran-and-social-affairs-molevsa-serbia-128290>





Inspektorati i punës për çdo vit harton Planin e Punës me qëllim të arritjes së prioritetëve të inspektimit të punës.<sup>166</sup>

**Këshilli për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**- u formua në vitin 2005, ka këto detyra: jep kontribut në miratimin e rregulloreve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, në zhvillimin e programit kombëtar për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe në hartimin e politikave parandaluese për çështjet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.<sup>167</sup>

Serbia	
Korniza Legjislative	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtetuta</li> <li>- Ligji i të Drejtës në Punë</li> <li>- Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë</li> </ul>
Korniza Institucionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale,</li> <li>- Inspektorati i Punës</li> <li>- Këshilli për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë</li> </ul>

## LETONIA

### Korniza Legjislative

<sup>166</sup> Plani i Inspektimit i Inspektoriatit të Punës (2021) Marrë nga:

<https://inspektor.gov.rs/page/635/%D0%9F%D0%BB%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8-%D0%B8%D0%BD%D1%81%D0%BF%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D1%81%D0%BA%D0%BE%D0%B3-%D0%BD%D0%B0%D0%B4%D0%B7%D0%BE%D1%80%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-2020>

<sup>167</sup> Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale. (2020). Raporti i Punës. Marrë nga:

<https://www.minrzs.gov.rs/sites/default/files/2021-03/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BE%20%D1%80%D0%B0%D0%B4%D1%83%20%D0%A3%D0%BF%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B5%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B1%D0%B7%D1%80%20%D0%B7%D0%B0%202020.%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D1%83.pdf>





Sistemi i sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit përcaktohet nga Ligji për Mbrojtjen e Punës dhe disa aspekte të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë të mbuluara nga ligji tjetër kryesor Ligji i Punës.

Qëllimi i Ligjit për Mbrojtjen e Punës është garantimi dhe përmirësimi i mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve dhe personave të vetëpunësuar në punë, duke përcaktuar detyrimet, të drejtat dhe marrëdhëniet e ndërsjella në mbrojtjen e punës midis punëdhënësve, punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, personave të vetëpunësuar, dhe gjithashtu autoritetet shtetërore.<sup>168</sup>

Ligji për Mbrojtjen në vendin e punës ka më shumë se 20 rregullore që i detajzojnë kërkesat e veçanta që parashikohen me këtë ligj. Këto rregullore lëshohen nga Kabineti i Ministrave pasi që sistemi ligjor Letonez është ndërtuar në mënyrën që kërkesat e përgjithshme ligjore, miratohen nga Parlamenti dhe më pas zbatohen nga rregulloret e miratuara nga Kabineti i Ministrave.<sup>169</sup>

Sipas "Ligjit për Mbrojtjen në Vendin e Punës", çdo punëdhënës është përgjegjës që të bëjë mbikëqyrjen e brendshme të vendit të punës, përfshirë vlerësimin e rreziqeve në mjedisin e punës, krijimin e një strukture organizative të mbrojtjes së punës në kompani si dhe të jap këshilla për punonjësit në lidhje me përmirësimin e mbrojtjes së punës, në mënyrë që të krijohet një sistem i duhur i Sigurisë dhe Shëndetit në Kompani<sup>170</sup>.

Egzistojnë edhe disa ligje të tjera në fushën e legjislacionit për siguri dhe shëndeti në punë, të cilat janë:

- Ligji për sigurimin e detyrueshëm shoqëror në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale
- Ligji për mbikëqyrjen e pajisjeve të rrezikshme
- Ligji për substancat kimike
- Ligji për Sigurinë nga Zjarri dhe Zjarrfikje<sup>171</sup>

## Korniza institucionale

**Ministria e Mirëqenies**, është përgjegjëse për politikën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Letoni është Ministria e Mirëqenies, brenda të cilës vepron Departamenti i Marrëdhënieve të

---

<sup>168</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar - Letonia. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_systems\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Latvia](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_systems_at_national_level_-_Latvia)

<sup>169</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar - Letonia. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_systems\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Latvia](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_systems_at_national_level_-_Latvia)

<sup>170</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar - Letonia. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_systems\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Latvia](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_systems_at_national_level_-_Latvia)

<sup>171</sup> Sistemi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në nivel kombëtar - Letonia. Marrë nga:

[https://oshwiki.eu/wiki/OSH\\_systems\\_at\\_national\\_level\\_-\\_Latvia](https://oshwiki.eu/wiki/OSH_systems_at_national_level_-_Latvia)







Punës dhe Politikës së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ndërsa kontrolli i sistemit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në praktikë, sigurohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës i cili vepron nën mbikëqyrjen e Ministrisë në fjalë.<sup>172</sup>

**Inspektorati Shtetëror i Punës-** Funkzioni kryesor i Inspektoratit është në përputhje me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Punës i miratuar më 19 Qershor të vitit 2008, duke shfuqizuar ligjet paraprake.

Udhëhiqet nga Drejtori i Inspektoriatit të Punës, i cili emërohet dhe shkarkohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shërbimit Civil Shtetëror nga Ministri i Mirëqenies. Inspektorati i Punës çdo vit vendos objektivat kyçe të cilat duhet realizuar brenda vitit pasues.<sup>173</sup>

Inspektorët duhet të jenë të diplomuar në këto fusha: Inxhinieri, Shkenca Natyrore, Shëndetit dhe Sigurinë e Punës, Juridik.<sup>174</sup> Pas përzgjedhjes, Inspektorët marrin trajnim prej 200 orësh si dhe trajnime vjetore të cilat organizohen nga Shkolla Letoneze e Administratës Publike dhe nga ndërmarrje të ndryshme të shërbimeve të trajnimit.<sup>175</sup>

Gjatë vitit 2020 Inspektorati i Punës ka vepruar me 123 inspektorë dhe gjithësej ka realizuar 10,384. Rrjedhimisht një inspektor në Letoni kryen 84 inspektime në vit.

Inspektorati financohet nga buxheti i shtetit, gjobat administrative të shiqptuara nga Inspektoriatit i transferohen në të ardhurat e buxhetit bazë të shtetit.<sup>176</sup>

Letonia	
Korniza Legjislative	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji për Mbrojtjen në Punës</li><li>- Ligji i Punës</li></ul>

<sup>172</sup> Ligji për Inspektoratin Shtetëror të Punës. Letoni. Marrë nga: <https://likumi.lv/ta/id/177910-valsts-darba-inspekcijas-likums>

<sup>173</sup> Ligji për Inspektoratin Shtetëror të Punës. Letoni. Marrë nga: <https://likumi.lv/ta/id/177910-valsts-darba-inspekcijas-likums>

<sup>174</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS\\_209359/lang-en/index.htm#:~:text=The%20State%20labour%20Inspectorate%20](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_209359/lang-en/index.htm#:~:text=The%20State%20labour%20Inspectorate%20)

<sup>175</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës. Marrë nga: [https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS\\_209359/lang-en/index.htm#:~:text=The%20State%20labour%20Inspectorate%20](https://www.ilo.org/labadmin/info/WCMS_209359/lang-en/index.htm#:~:text=The%20State%20labour%20Inspectorate%20)

<sup>176</sup> Ligji për Inspektoratin Shtetëror të Punës. Letoni. Marrë nga: <https://likumi.lv/ta/id/177910-valsts-darba-inspekcijas-likums>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji për sigurimin e detyrueshëm shoqëror në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale</li> <li>- Ligji për mbikqyrjen e pajisjeve të rrezikshme</li> <li>- Ligji për substancat kimike</li> <li>- Ligji për Sigurinë nga Zjarri dhe Zjarrfikje</li> </ul>
Korniza Institucionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Mirëqenies</li> <li>- Inspektorati Shtetëror i Punës</li> </ul>

Analizë Krahasimore (2019)							
	Nr. i inspektorve	Nr. i inspektimeve	Numri total i aksidenteve	Numri i aksidenteve të lehta	Numri i aksidenteve të rënda	Numri i vdekjeve	Numri i gjobave
Kosova	33	14000	143	75	58	10	220
Shqipëria	90	5993	182	-	-	36	85
Maqedonia e Veriut	115	23821	2034	-	-	24	67
Serbia	262		1029	8623	1662	114	216
Sllovenia	31	5891	191	183	6	2	281
Kroacia	215	-	-	982	-	53	-
Letonia	123	10384	2272	2017	226	29	1520





Nr.	Kosovë	Shqipëri	Maqedoni e veriut	Serbi	Slloveni	Kroaci	Letoni
<b>Kualifikimet për Kryeinspektorë/e</b>	- Diplomë universitare; -Tetë (8) vite përvojë pune; -Pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale	-Diplomë Universitare - pesë (5) vite përvojë pune	-Diplomë universitare -Pesë (5) vite përvojë pune -Të ketë kaluar testin psikologjik dhe një test të intergjetitit -Të njoh gjuhën angleze, të ketë një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht	/	/	-Diplomë Universitare -Pesë vite përvojë pune, prej tyre 2 vite si inspektorë	/
<b>Kualifikimet për Inspektorë/e</b>	-Diplomë universitare (juridik, shkenca teknike) -Tre (3) vite përvojë pune profesionale.	/	/	Diplomë universitare në: Drejtësi, Ekonomi. Inxhinier i ndërtimit, makinerisë, elektroteknikës, arkitekturës, inxhinier kimisë; gjeolog.	-Diplomë universitare në shkencat juridike, ekonomike, ose teknike -Pesë (5) vite përvojë pune -Te ketë kaluar provimin profesional	-Diplomë universitare -Dy (2) vite përvojë pune	-Diplomë universitare në shkencat juridike, inxhinierike, shkencat natyrore, ose të sigurisë dhe shëndetit në punë.





					për inspektor		
--	--	--	--	--	------------------	--	--





## Rekomandime

- Të rritet numri i zyrtarëve brenda Divizionin të Marrëdhënieve të Punës, Dialogut Social, Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transferës edhe për gjashtë (6) zyrtarë.
- MFPT të hartoj rregullore të re për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës .
- IP të hartoj rregullore të re për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës
- Të rritet numri i inspektorëve të punës për 100-150 inspektorë
- Të rritet numri i stafit administrativë në IP.
- Të ndahen inpektorët në inspektorë të punës si dhe inspektorë të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Matja e masës së gjobës për personat fizik që përcaktohet me ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës të bëhet në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje.
- Të themelohet një komision si organ i shkallës së dytë për shqyrtimin e ankesave ndaj Inspektoratit të Punës me vendim të ministrit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.
- Inspektorati i Punës të i konfirmojë rastet e aksidenteve në punë të cilat ndodhin në veprimtarin minerare, verifikimi i kushteve të sigurisë në këtë veprimtari të kryhet nga Inspektorati i Minierave.

